



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në  
"Inxhinieri Elektrike", me profile "Sistemet e Fuqisë",  
"Elektronikë", "Komunikime Dixhitale", "Kontroll  
Inxhinierik", "Makineri Elektrike"**

**i**

**"Universiteti Metropolitan Tiranë"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof.Asoc. Genci Sharko**

**Dr. Lindita Dhamo**

Shkurt 2022


# PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit i ciklit të dytë “Bachelor në Inxhinieri Elektrike” që zhvillohet dhe administrohet nga Universiteti Metropol Tirana, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT , Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike, është hartuar në përputhje të plotë me qëllimin e objektivat e tij të sanksionuara në Statutin e UMT dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare të zhvillimit të arsimit të lartë dhe të tregut të punës. Ky program studimi ka 5 drejtime: "Sistemet e Fuqisë", "Elektronikë", "Komunikime Dixhitale", "Kontroll Inxhinierik", "Makineri Elektrike”, nga të cilët janë aktiv vetëm dy prej tyre. Numri i studentëve të regjistruar është relativisht i ulët edhe pse kjo IAL ka hartuar procedura lehtësuese për pranimin e studentëve edhe nga Kosova, Republika e Maqedonisë së Veriut, Serbia e Mali i Zi.

UMT bën përpjekje të vazhdueshme për rritjen e nivelit të mësimdhënies duke rekrutuar staf akademik me ekspertizë profesionale në përputhje me programin e studimit edhe pse ka vështirësi në punësimin e stafit të ri akademik efektiv me grada shkencore. Stafi akademik ka mbingarkesë mësimore dhe mbingarkesë lëndësh semestrare, vështirësi që shkaktohet prej numrit të lartë të programeve të studimit dhe numrit të vogël të studentëve(klasave).

UMT ka garantuar për studentët e FSHKIT një infrastrukturë bashkëkohore (auditore, laboratore, biblioteka, zyra etj) dhe të mjaftueshme për të gjitha programet e studimit, që financohet kryesisht nga tarifat e shkollimit. Struktura akademike dhe ndihmës akademike mbështet studentët dhe stafin akademik në përparimin e tyre. Kjo strukturë përmes akteve të brendshme rregullatore, garanton barazi dhe transparencë të proceseve brenda UMT. Gjithashtu, studentët përfshihen në vendimmarrjen e UMT në të gjitha nivelet dhe sistematikisht iu merret mendim në lidhje me cilësinë e mësimdhënies në UMT. Nga UMT është në vëmendje mbështetja e studentëve edhe pas diplomimit, përmes rrjetit Alumni dhe bashkëpunimeve të shumta që ka me biznese e subjekte shtetërore e private të fushës së inxhinierisë elektrike dhe jo vetëm.



## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Vlerësimi i jashtëm u krye duke u mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë dhe në standardet e udhëzimet përkatëse të cilësisë në Hapësirën Europiane dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë, hartuar nga ASCAL. Ekspertiza e vlerësimit të jashtëm është kryer në kuadër të akreditimit të programeve të studimit që Universiteti Metropol Tirana ka kërkuar për programin e studimit "Bachelor në Inxhinieri Elektrike" me 5 drejtime: "Sistemet e Fuqisë", "Elektronikë", "Komunikime Dixhitale", "Kontroll Inxhinierik", "Makineri Elektrike", duke dhënë vlerësime analitike dhe krahasuese për këtë program studimi.

Procesi i vlerësimit të jashtëm u krye në plotësim të këtyre parimeve:

- Paanshmëria në gjykimin e dhënien e vlerësimeve, për ruajtjen e standardeve dhe promovimin e përmirësimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë. Ekspertët e vlerësimit të jashtëm në gjykimet e tyre janë mbështetur vetëm në faktet e dokumentuara që UMT ka ofruar, bazuar në standardet që ASCAL ka miratuar, dhe duke qenë krejtësisht të hapur për diskutimin bashkarisht të çështjeve që mund të ngrenë debat.
- Transparencë në trajtimin e çështjeve të rëndësishme dhe përcaktuese që jo vetëm karakterizojnë institucionin, por edhe japin avantazhet e disavantazhet kundrejt IAL-ve të ngjashme, japin sugjerime të dobishme në ndihmesë të përparimit të qëndrueshëm të IAL-ve.
- Pavarësia dhe objektiviteti në marrjen e vendimeve bazuar në argumentim të thelluar të fakteve.

Përmes shqyrtimit të dosjes së akreditimit, është kryer vlerësimi i cilësisë akademike dhe i cilësisë së mësimdhënies, i përputhshmërisë me standardet e cilësisë që UMT ofron në këtë program studimi.

Koordinator teknik nga ASCAL në këtë vlerësim ka qenë Msc. Arjana Alija.

Universiteti "Metropolitan Tirana" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 20.12.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 26/58 Prot, datë 20.12.2021. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 07.01.2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 69 Prot, datë 02.02.2022.

**GVJ pasi u njohën me komentet e institucionit mbi Draft- Raportin sqaron si vijon:**

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteri	Vlerësimi i ekspertëve:	Masat e mara nga UMT	Vlerësimi i ekspertëve përfundimtar
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<b>Përmbushet kryesisht:</b> Kategoria "Profesor" ka moshe mesatare të lartë, mbi 66 vjeç	Ky është problem kombëtar por me hapjen e studimeve doktorale do të zbutet	<b>Përmbushet kryesisht:</b> Mbetet vlerësimi i mëparshëm, përmirësimet janë objekt i vlerësimit të ardhshëm të akreditimit dhe nuk ndryshojnë statusin aktual të vlerësimit të kryer pranë institucionit.

**Standardi II.5**

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

Kriteri	Vlerësimi i ekspertëve:	Masat e mara nga UMT	Vlerësimi i ekspertëve përfundimtar
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<b>Përmbushet kryesisht:</b> Për Vitin akademik 2018-2019, të dhënat janë të pjesshme, vetëm për vitin I. Për vitin akademik 2019-2020 ka mungesë të dhënash për lëndën "Hyrje në shkencat Kompjuterike". Për vitin akademik 2020-2021, tabela e ngarkesës mësimore është plotësuar gabim, pasi për shumë pedagogë është vendosur ngarkesa totale e tyre si ngarkesë e lëndës, duke e shumëfishuar artificialisht ngarkesën. Kërkesa ligjore që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% të ngarkesës, nuk mund të vlerësohet saktë nga të dhënat e tabelave edhe pse duke hamendësuar nga përfshirja e stafit PAE dhe PAK në lëndë të ndryshme, duket se përmbushet.	Programi i studimit është aktivizuar për here të pare ne vitin akademik 2018-2019 prandaj janë të dhënat vetëm për vitin e pare ne atë vit akademik. Nuk ka patur vit të dyte dhe të trete studimi. Gjithashtu tashme janë kryer rekrutime të reja për vitin akademik 2021-20221 çka ka sjelle reduktim të ngarkesës për stafin drejtues që gjithsesi sipas VKM ne fuqi duhet të plotësojë ngarkesën kontraktuale. Rekomandimet e eksperteve janë ekzekutuar nga fakultetit që pas vizitës në institucion. Ne çdo rast theksojmë se i gjithë stafi drejtues dhe i angazhuar për zhvillimin e programit të studimit është tërësisht i	<b>Përmbushet kryesisht:</b> Mbetet vlerësimi i mëparshëm, përmirësimet janë objekt i vlerësimit të ardhshëm të akreditimit dhe nuk ndryshojnë statusin aktual të vlerësimit të kryer pranë institucionit.

	Kategoria profesor ka një ngarkesë vjetore të lartë për këtë kategori.	kualifikuar brenda fushës së studimit që plotëson programi i studimit.	
--	--	--	--

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteri	Vlerësimi i ekspertëve:	Masat e mara nga UMT	Vlerësimi i ekspertëve përfundimtar
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<b>Përbushet kryesisht:</b> Mbetet shqetësim numri i ulët i pjesëmarrjes së stafit akademik PAE në konferenca ndërkombëtare dhe botimeve shkencore. Nga tabela 20 e Aneksit, shihet se ka vetëm 1 pjesëmarrje në aktivitete shkencore jashtë IAL dhe asnjë leksion të hapur nga lektorë të huaj.	Kjo mangësi do të reduktohet duke rritur bashkëpunimin me universitetet partnere.	<b>Përbushet kryesisht:</b> Mbetet vlerësimi i mëparshëm, përmirësimet janë objekt i vlerësimit të ardhshëm të akreditimit dhe nuk ndryshojnë statusin aktual të vlerësimit të kryer pranë institucionit.

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficientë dhe efektive**

Kriteri	Vlerësimi i ekspertëve:	Masat e mara nga UMT	Vlerësimi i ekspertëve përfundimtar
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<b>Përbushet kryesisht:</b> institucioni, ka një listë me 21 subjekte IAL brenda e jashtë vendit, për bashkëpunime e mobilitete të stafit e studentëve, por nuk ka specifikime në lidhje me përfitimet që ka patur DIEE nga këto marrëveshje. Nga vizita në institucion, në takimim me Përgjegjës e Departamentit u konfirmua se nga PS Bachelor në Inxhinieri Elektrike nuk ka patur mobilitet as nga studentët as nga stafi.	Kjo mangësi do të reduktohet duke rritur bashkëpunimin me universitetet partnere.	<b>Përbushet kryesisht:</b> Mbetet vlerësimi i mëparshëm, përmirësimet janë objekt i vlerësimit të ardhshëm të akreditimit dhe nuk ndryshojnë statusin aktual të vlerësimit të kryer pranë institucionit.

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësim nxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësim nxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësim nxënies për studentët e programit të studimit**

Kriteri	Vlerësimi i ekspertëve:	Masat e mara nga UMT	Vlerësimi i ekspertëve përfundimtar

46

<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p><b>Përmbushet kryesisht:</b> Fondi i saj nevojitet të pasurohet me tituj të rinj dhe revista teknike bashkëkohore.</p>	<p>Do të merren masa për rritjen e fondeve duke u mbështetur dhe tek institucionet private që DIEE ka partneritet. Do të shfrytëzohet dhe burimet e hapura shume te pasura on-line.</p>	<p><b>Përmbushet kryesisht:</b> Mbetet vlerësimi i mëparshëm, përmirësimet janë objekt i vlerësimit të ardhshëm të akreditimit dhe nuk ndryshojnë statusin aktual të vlerësimit të kryer pranë institucionit.</p>
---	---	---	---

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteri	Vlerësimi i ekspertëve:	Masat e mara nga UMT	Vlerësimi i ekspertëve përfundimtar
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p><b>Përmbushet kryesisht:</b> Raporti financiar mbi të ardhurat dhe shpenzimet që UMT kryen për realizimin e misionit si IAL, është paraqitur si informacion në rang institucioni por jo në rang fakulteti. Nuk ka një plan financimi të argumentuar të programit të studimit në rang fakulteti në lidhje me financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit.</p>	<p>Te dhënat dhe raportimet financiare, sikundër dhe mbulimet e kostove dhe investimeve kryhen në nivel institucional, prandaj janë paraqitur te tilla në DVV. Aktualisht, programi i studimit është në vitet e para të zhvillimit të tij, si rezultat investimet ofrohen nga të ardhurat e qëndrueshme të institucionit, të përftuara edhe nga programet e tjera në rang fakulteti apo institucioni. Menaxhimi financiar kryhet në nivel qendror, duke ofruar çdo informacion të kërkuar. Nëse do kërkohej, patjetër që do vihej në dispozicion plani financiar i detajuar i programit të studimit.</p>	<p><b>Përmbushet kryesisht:</b> Mbetet vlerësimi i mëparshëm, përmirësimet janë objekt i vlerësimit të ardhshëm të akreditimit dhe nuk ndryshojnë statusin aktual të vlerësimit të kryer pranë institucionit.</p>

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteri	Vlerësimi i ekspertëve:	Masat e mara nga UMT	Vlerësimi i ekspertëve përfundimtar
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<b>Përbushet kryesisht:</b> Studentët aktuale janë me notë mesatare të ulët, për pasojë janë aktive vetëm 2 programe studime nga 5 potencialë që ka UMT në Bachelor në Inxhinieri Elektrike dhe Elektronike.	DIEE do të bëjë përpjekje për rritje të numrit të studentëve me note mesatare në rritje duke promovuar prioritetet që ka UMT. Megjithatë, theksojmë se ky është një program me disa profile studimi, pikërisht për t'ju përshtatur kërkesave në ndryshim të tregut të punës.	<b>Përbushet kryesisht:</b> Mbetet vlerësimi i mëparshëm, përmirësimet janë objekt i vlerësimit të ardhshëm të akreditimit dhe nuk ndryshojnë statusin aktual të vlerësimit të kryer pranë institucionit.

**Standardi V.6**

**Institucioni ka procedurë të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve dhe problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

Kriteri	Vlerësimi i ekspertëve:	Masat e mara nga UMT	Vlerësimi i ekspertëve përfundimtar
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<b>Përbushet kryesisht:</b> Mungon një database me të dhënat e ecurisë profesionale të diplomuarve.	DIEE në bashkëpunim me Departamentin e inxhinierisë Kompiuterike do të marrë masat për krijimin e një database me të dhënat e ecurisë profesionale të diplomuarve.	<b>Përbushet kryesisht:</b> Mbetet vlerësimi i mëparshëm, përmirësimet janë objekt i vlerësimit të ardhshëm të akreditimit dhe nuk ndryshojnë statusin aktual të vlerësimit të kryer pranë institucionit.

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

Kriteri	Vlerësimi i ekspertëve:	Masat e mara nga UMT	Vlerësimi i ekspertëve përfundimtar
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të	<b>Përbushet kryesisht:</b> Aktet rregullatorë nuk janë të rifreskuara.	Aktualisht, institucioni ka të përditësuar sa më poshtë: 1. Politikat e Cilësisë 2. Manualin e Cilësisë 3. Procedurat e Cilësisë	<b>Përbushet kryesisht:</b> Mbetet vlerësimi i mëparshëm, përmirësimet janë objekt i vlerësimit të ardhshëm të akreditimit dhe nuk ndryshojnë statusin aktual të vlerësimit të kryer pranë institucionit.

interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.		Ne zbatim të Statutit dhe Rregullores së Brendshme të institucionit. Kopje bashkëngjitur.	
--	--	---	--



Kriteri	Vlerësimi i ekspertëve:	Masat e mara nga UMT	Vlerësimi i ekspertëve përfundimtar
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<b>Përbushet kryesisht:</b> Pothuajse mungon një vlerësim real dhe efektiv i programit të studimit nga aktore dhe eksperteve të jashtëm	Ne NJSBC, me Vendim të Senatit Akademik, një nga anëtarët e njësisë është pikërisht eksperti i jashtëm, i cili kryen rishikimin e gjithë procesit të vetëvlerësimit. Bashkëngjitur VSA.	<b>Përbushet kryesisht:</b> Mbetet vlerësimi i mëparshëm, përmirësimet janë objekt i vlerësimit të ardhshëm të akreditimit dhe nuk ndryshojnë statusin aktual të vlerësimit të kryer pranë institucionit.



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “ Inxhinieri Elektrike me 5 profile”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>			
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti Metropolitan Tiranë sipas rregullores së programit të studimit, GVJ vlerëson se programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Inxhinieri Elektrike" në "Universiteti Metropolitan Tirane", ofruar prej DIEE, është në përputhje me misionin e UMT shprehur në statutin e institucionit dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ky program studimi synon formimin e inxhinierëve elektrikë në përputhje me kërkesat e tregut të punës, gjë që synohet me numrin e lartë të drejtimeve (5) edhe pse janë aktive vetëm 2 drejtime.</p> <p><i>[Evidenca nr 01: Statuti UMT]. [Evidenca nr 03: Plani strategjik i zhvillimit UMT]</i></p>		
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Metropolitan Tiranë" nëpërmjet Planit Strategjik të tij GVJ vlerëson se programet e studimit për Ciklit të Parë Bachelor në "Inxhinieri Elektrike", ruajnë dhe konsolidojnë vlerat akademike e kulturore kombëtare. Ai synon t'u japë studentëve një edukim cilësor, kontribut në kërkim të qëndrueshëm në përdorimin e arritjeve më të mira të shkencës.</p> <p><i>[Evidenca nr 01: Statuti UMT]. [Evidenca nr 03: Plani strategjik i zhvillimit UMT].</i></p>		
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ vlerëson se programi studimit i Ciklit të Parë Bachelor "Inxhinieri Elektrike", është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e Inxhinieri Elektrike.</p> <p><i>[Evidenca nr 03: Plani strategjik i zhvillimit UMT.]</i></p>		
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	<p>GVJ vlerëson nga dokumentacionit të dorëzuar nga "Universiteti Metropolitan Tiranë" se programi i Ciklit të Parë Bachelor "Inxhinieri Elektrike", është ngritur dhe hapur bazuar në studimin e tregut.</p> <p><b><i>Ky studim tregu bazohet tek të dhënat e INSTAT për punësimin e kërkesat e tregut për profesione të ndryshme, por fokusi është tek specialiteti IT, ndërsa për inxhinierët elektrikë ka pak informacion.</i></b></p> <p><i>[Evidenca Nr.08, Studimi Periodik i Tregut te Punes]</i></p>		
	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>Përmbushet plotësisht</b>

Shkalla e përmbushjes së standardit				<input checked="" type="checkbox"/>
-------------------------------------	--	--	--	-------------------------------------

<b>Standardi I.2</b>				
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	GVJ vlerëson se programi i studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike”, është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit i cili ka si objektiva strategjike cilësinë dhe performancën akademike. Përmbushja e misionit të “Universitetit Metropolitan Tiranë” planifikohet të realizohet dhe duke siguruar shumëllojshmëri të ofertave të formimit në përputhje me nevojat e zhvillimit industrial perspektiv të vendit.  [Evidenca nr 03: Plani strategjik i zhvillimit UMT]. [Evidenca Nr. 23, Plani Mesimor]			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti i “Universitetit Metropolitan Tiranë” përcakton qartë drejtimit prioritare akademike të tij. Drejtimit prioritare akademike të universitetit përputhen me fushat e studimit të programit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike”, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT dhe Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike, prej nga varet programi i studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike”.  [Evidenca nr 01: Statuti UMT.] [Evidenca nr 03: Plani strategjik i zhvillimit UMT]			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	GVJ vlerëson se programi i Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” emërtohet , organizohet si edhe ka përmbajtje në përputhje me fushën akademike të inxhinierisë elektrike e cila është një prej drejtimeve akademike të “Universitetit Metropolitan Tiranë”.  [Evidenca nr 01: Statuti UMT.] [Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<input checked="" type="checkbox"/>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB, GVJ konstaton se programi i studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” realizohet në përputhje me objektivat e përcaktuara prej nga rrjedhin edhe qartësisht objektivat e mësimdhënies. Bazuar në rregulloren e programit, objektivat formues përfshijnë pajisjen e studenteve me njohuri të avancuara në fushën e inxhinierisë elektrike. Nëpërmjet këtij programi studimi synohet ndër të tjera që studentët, të jenë në gjendje të:

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dizenojnë zgjidhje të problematikave në fushën e inxhinierisë elektrike duke shfrytëzuar analiza të aplikuara, bazuar në kërkesat e industrisë.</li> <li>• Të identifikojnë, vlerësojnë dhe zbatojnë teknologjitë aktuale duke marrë parasysh zbatueshmerinë e tyre ndaj nevojave individuale dhe organizative. Këto objektiva janë pasqyruar tek kurrikula , organizimi i planit mësimor, ndarja e moduleve në vite, sylabuset, shpërndarjen e orëve teorike/praktike, laboratorët dhe praktikat profesionale.</li> </ul> <p>GJV nga shqyrtimi dokumentacionit vlerëson se programi i Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” pranë “Universitetit Metropolitan Tiranë”, është hapur në përputhje me kërkesën e tregut për profesionin e inxhinierit Elektrik.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit].</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni ka realizuar studimin për tregun e punës. Në këtë studim përfshihen të dhëna nga komunikimi me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve. Nga të dhënat tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve, të programit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike”.</p> <p>Institucioni akoma nuk ka kryer studime mbi tregun ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 81Alumni: Rezultatet e te diplomuarve ne tregun e Punes]</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formuese, përmbajtja dhe struktura e programit të studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike”. mundësojnë rezultate të mira të të nxënësve duke garantuar përfundimin e dijeve, aftësive e kompetencave sipas nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. Studentët që diplomohen në programin e studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike”, mund të punojnë si: inxhinier elektrik, etj</p> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit].</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				☒

#### Standardi I.4

**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>GVJ konstaton, nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizitave në institucion, se “Universitetit Metropolitan Tiranë”, ka përvojën dhe eksperiencë që prej vitit 2011 në fushën akademike, kapacitetet si në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse universitare.</p> <p>Personeli Akademik Efektiv (PAE) ku zhvillohet programi i studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike”, në vitin akademik 2020-2021 përbëhet nga: 3 Profesorë, 2 Profesorë te Asociuar, 1</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	Lektorë me gradën Dr dhe 4 Asistent-Lektorë me gradën Msc., ku 1 prej tyre është në proces doktrate. Ky departament ka raport stafi akademik PAE/PAK si 10/11(Tabela 1).			
	<i>[Evidenca Nr.82, Lista e Stafit Akademik] [CV Emër Mbiemër].</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Njësia kryesore FSHKIT, ofron programe studimi në fushën e inxhinierisë elektrike që prej vitit 2011. Drejtimit kërkimore shkencore 2020-2021 të FSHKIT janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore . Programi i studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike”, i ofruar nga Departamentit te Inxhinierise Elektrike dhe Elektronike ka si fushë të përgjithshme fushën e inxhinierisë elektrike të përputhur me fushën akademike dhe shkencore të njësisë kryesore.			
	<i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit].</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	GVJ konstaton se aktiviteti mësimor-kërkimor i Departamentit te Inxhinierise Elektrike dhe Elektronike është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FSHKIT. <b><i>Kurikula e këtij programi studimi evidenton qartë orientimin e aktivitetit mësimor në drejtim të formimit të inxhinierit elektrik në 5 drejtime: "Sistemet e Fuqisë", "Elektronikë", "Komunikime Dixhitale", "Kontroll Inxhinierik", "Makineri Elektrike". Prej tyre janë aktive vetëm dy drejtime. Numri i lartë i drejtimeve mundëson një ofertë të mirë per tregun, por kërkon një staf akademik më të madh e më të specializuar, pra do e rriste së tepërmi koston e tyre.</i></b>			
	<i>[Evidenca nr 01: Statuti UMT.] [Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit].</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				☒

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fudit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ndarja e detyrave mes njësisë e personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloren tij dhe në rregulloren e njësisë kryesore. Nga vlerësimi rezulton se Departamentit te Inxhinierise Elektrike dhe Elektronike menaxhon Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike”, i cili ka një kohëzgjatje 3-vjeçare dhe në total përmban 180 kredite. Vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit si : Njësia e Brëndshmë e Sigurimit të Cilësisë, Sekretaria mësimore, Arkiva dhe protokollit, Zyra e burimeve njerëzore, Zyra e zhvillimit të kurrikulave, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë etj dhe departamentet e tjera në FSHKIT të “Universitetit Metropolitan Tiranë”, gje qe con ne përmirësimin e efektivitetit te këtij programi studimi.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: www.ascal.al

	<p>[Evidenca Nr.02, Rregullore e Brendshme e UMT]  [Evidenca Nr.14, Raportet vjetore te publikuara per monitorimin dhe sigurimin e cilësisë]</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se, “Universitetit Metropolitan Tiranë”, ka bashkëpunime ndërinstitucionale me institucione shtetërore dhe IAL brenda vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës. Realizimi i praktikave profesionale mbetet një ndër bashkëpunimet kryesore me këto institucione. Me anë të këtyre bashkëpunimeve “Universitetit Metropolitan Tiranë”, synon gjithashtu krijimin e lidhjeve midis universitetit dhe aktorëve të tregut të punës në funksion të punësimit të studentëve por edhe për të qënë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit.</p> <p>[Evidenca Nr.56, Lista e kompanive me te cilet institucioni ka marreveshje bashkepuoimi]</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se “Universitetit Metropolitan Tiranë”, ka realizuar një analizë të Departamentit të Inxhinierise Elektrike dhe Elektronike përgjegjës për programin e studimit. Në të nuk ka raportim analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p> <p>GVJ sugjeron që krahas rritjes së numrit të bashkëpunimeve, “Universitetit Metropolitan Tiranë”, të kujdeset edhe për hartimin e raporteve analitike të përfitimit nga marrëveshjet.</p> <p>[Evidenca Nr.55, Raport vjetor i aktiviteti mesimor, kerkimor dhe financiar] [Vizita në Institucion: Shenime ne vizite]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>GVJ konstaton se, procedura e zhvillimit të praktikave profesionale është e rregulluar nëpërmjet udhëzuesit për zhvillimin e praktikës. Në të janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësisive të ndryshme të përfshira në këtë proces.</p> <p>[Evidenca Nr.56, Lista e kompanive me te cilet institucioni ka marreveshje bashkepuoimi] [Evidenca Formulari i praktikës]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i materialeve në dosjen e akreditimit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se UMT organizon takime dhe aktivitete të tjera me studentët e diplomuar përmes rrjetit ALUMNI, por <b>nuk evidentohet organizim trajnimesh pas diplomimit</b>.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				☒

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				☒

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike”, vlerësohet nga GVJ si i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje normale 3 vite dhe në total 180 kredite.</p> <p><i>[VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018; VKM Nr.879, date 18.12.2019] [Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit] [Evidenca Nr.23, Plani Mesimor]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike”, nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara krijon mundësinë e formimin e shprehive të veçanta. Studimi i Tregut evidentoj disa specialitete për të cilat formohen studentët e këtij programi. Disa nga profesionet dhe specialitetet për të cilat formohen studentët e Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike”, janë: inxhinier elektrik, etj.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit][Evidenca Nr.23, Plani Mesimor] [Syllabuse 2020- 2021]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistave gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se programi të studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike”, thellon njohuritë e studentëve në fushën e Inxhinieri Elektrike, ku një vend të konsiderueshëm në program zë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve të fushës së automatizimit të industrisë.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit];[ Syllabuse 2020-2021]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” ka ndër objektivat kryesore t’u mundësojë studentëve njohuritë me kryesore dhe më bashkëkohore të nevojshme në fushën e automatizimit industrial. Gjithashtu programi synon që studentët të jenë në gjendje të përcaktojnë zgjidhje të proceseve teknologjike në fushën e inxhinierisë elektrike duke shfrytëzuar analiza dhe kritere të aplikuara në këtë fushë për sisteme të tilla. GVJ konstaton se objektivat formuese përmbushen mirë.</p> <p><i>[Evidenca Nr.23, Plani Mesimor];[ Syllabuset 2020-2021]. [Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit: Objektivat Formues të programit]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” përcakton në mënyrë të detajuar shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj., të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore. Për të gjitha lëndët/modulet janë dhënë ngarkesa në kredite, format e ndryshme të mësimdhënies, orët mësimore në auditor dhe ngarkesa jashtë auditorit, kategoria të cilës i përket, etj.</p>

	[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit; Evidenca Nr.23, Plani Mesimor]			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<p>GVJ konstaton se programit mësimor dhe syllabuseve rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh.</p> <p>GVJ konstaton se lëndët/modulet janë grupuar sipas veprimtarive formuese në përputhje me (Ligjin 80/2015 dhe VKM nr.41, dt.24.01.2018).</p> <p>Programi ka të përcaktuara veprimtaritë formuese, kryesisht leksione dhe seminare. Gjatë vizitës GVJ konstatoi laboratorët mbështes për shumicën e lëndëve laboratorike ku mundësohet dhe praktikimi i njohurive në praktikë. GVJ sugjeron shtimin e orëve laboratorike në veprimtaritë formuese të programit të studimit.</p> <p>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit];[ Evidenca Nr.23, Plani Mesimor] [Syllabus 2020-2021] [Vizita në Institucion]</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<input checked="" type="checkbox"/>

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Institucioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Programi i studimit Ciklit të Parë Bachelor "Inxhinieri Elektrike" është është Licensuar me Urdhërin e MASR Nr. 472, datë 27.07.2018. Pas këtij licensimi, Programi i studimit i Ciklit të Parë Bachelor "Inxhinieri Elektrike" i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit.</p> <p>Të dhëna Institucionale në lidhje me licensimin: VKM Nr. 357, date 12.05.2010, PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË "UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA", TIRANË. Në mbledhjen e senatit të datës 11.11.2011 (Vendim senati pa numër) u ndryshua emertimi i Fakultetit, nga Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave të Aplikuara në Fakulteti i Inxhinierisë. VKA Shpallje për akreditim VKA Nr. 98/1, datë 18.12.2015, Institucioni është akredituar me Urdhër Nr. 8 datë 07.01.2016 dhe u riakreditua me VBA Nr. 117 date 15.12.2017 me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati i vlefshmërisë 14.12.2022.</p> <p>Është miratuar Statuti i ri me emertimin Universiteti "Metropolitan Tirana", ky statut është miratuar me Urdhërin e MASR Nr. 611 datë 28.09.2018. Vendimet mbështetëse të Statutit janë: Vendimi i Bordit të Lartë Drejtues Nr. 935/2 date 26.07.2018 dhe Vendimi i Senatit Akademik Nr. 935/1 datë 26.07.2018.</p> <p>Bazuar në Statutin, VS dhe UMASR është ndryshuar emërtimin i Institucionit, duke ndryshuar kategorinë "Universiteti"</p>

	<p>Universiteti "Metropolitan Tirana" është akredituar me VBA nr. 45 datë 05.07.2019, deri më datë 14.12.2022.</p> <p>Pas miratimit të statutit me UMASR Nr. 611, date 28.09.2018, Institucioni është riorganizuar nga SHPAL në Universitet me UMASR Nr. 195, datë 01.04.2019, por në këtë urdhër emërtimi i dy departamenteve është ndryshe nga Statuti.</p>																																																
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Përgjegjësia për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij është e përgjegjës të departamentit.</p> <p>Përgjegjësia për ecurinë e praktikave profesionale përcaktohet në Udhëzuesin për zhvillimin e praktikës.</p> <p>Koordinatori për studentët koordinon marrëdhëniet mes studentëve dhe stafit, kryen këshillimin e studentëve në lidhje me kurrikulën dhe raporton për problematika të studentëve në departament dhe te përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit] [[Evidenca Formulari i praktikës]</i></p>																																																
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>FSHKIT përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Në këtë fakultet janë tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Inxhinierise Elektrike dhe Elektronike</li> <li>2. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike</li> <li>3. Qendra Kerkimore.</li> </ol> <p>Departamenti i Inxhinierise Elektrike dhe Elektronike, ku zhvillohet programi i studimit Ciklit të Parë Bachelor "Inxhinieri Elektrike", aktualisht ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 21 pedagoge prej të cilëve 10 me kohë të plotë</li> <li>- 11 me kohë të pjesshme nga këta</li> <li>- 4 pedagogë të kategorisë "Profesor", 2 të kategorisë "Prof. As", 1 të kategorise "Docent", 4 të kategorisë "Doktor".</li> <li>- DIEE ka edhe 1 punonjës si staf ndihmës akademik.</li> </ul> <p><i>[Evidenca Tabelat permbledhese]</i></p>																																																
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierise Elektrike dhe Elektronike ka aktivizuar në programin e studimit "Bachelor në Inxhinieri Elektrike" një numër pedagogësh sipas kësaj shpërndarjeje, sipas viteve akademike:</p> <table border="1" data-bbox="628 1364 1422 1704"> <thead> <tr> <th rowspan="3">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Viti Akademik 2018-2019</th> <th colspan="2">Viti Akademik 2019-2020</th> <th colspan="2">Viti Akademik 2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>0</td> <td>2</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Prof.Assoc</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>3</td> <td>6</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej</b></td> <td><b>7</b></td> <td><b>16</b></td> <td><b>8</b></td> <td><b>5</b></td> <td><b>9</b></td> <td><b>9</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga lista e stafit të angazhuar në këtë program studimi, vërehet se ka ndryshime të shumta si në numër ashtu edhe në përbërje, sidomos tek stafi akademik PAK. Gjithashtu vërehet se numri i stafit dhe kualifikimi i tyre përmbush kriteret.</p>	Kualifikimi i stafit	Viti Akademik 2018-2019		Viti Akademik 2019-2020		Viti Akademik 2020-2021		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1	3	3	0	2	0	Prof.Assoc	2	4	2	2	2	2	Dr/PhD	3	6	1	2	1	2	Msc	1	3	2	1	4	5	<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>16</b>	<b>8</b>	<b>5</b>	<b>9</b>	<b>9</b>
Kualifikimi i stafit	Viti Akademik 2018-2019		Viti Akademik 2019-2020		Viti Akademik 2020-2021																																												
	PAE		PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																										
	Prof.Dr	1	3	3	0	2	0																																										
Prof.Assoc	2	4	2	2	2	2																																											
Dr/PhD	3	6	1	2	1	2																																											
Msc	1	3	2	1	4	5																																											
<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>16</b>	<b>8</b>	<b>5</b>	<b>9</b>	<b>9</b>																																											



<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Për sa më sipër GVJ konstaton se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përgjithësisht përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Mbetet problematik fakti që kategoria “Profesor” ka moshë mesatare të lartë, mbi 66 vjeç.  <i>[Evidenca Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik][Evidenca Nr.16, Personeli Akademik i Departamentit]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			☒	

<b>Standardi II.3</b> <b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b>																													
<b>Kriteret</b>		<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																											
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ konstaton se Departamenti i Inxhinierise Elektrike dhe Elektronike disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: Rregulloren programin mësimor, syllabuset, orarin, ngarkesën e stafit akademik etj. Dosja e plotë e cdo viti mbahet në departamentin përkatës.  <i>[Evidenca Nr.16, Personeli Akademik i Departamentit]; [Evidenca Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik] [Evidenca Nr.23, Plani Mesimor] [Syllabus 2020 - 2021]</i>																												
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se veprimtaritë formuese janë shpërndarë në përputhje me VKM 41. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën më poshtë: <table border="1" data-bbox="726 1220 1401 1680" style="margin: 10px auto;"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kategoria</th> <th rowspan="2">Përqindja Krediteve Sipas VKM</th> <th colspan="2">Programi</th> </tr> <tr> <th>Kredite</th> <th>Përqindje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A. LËNDË BAZË</td> <td>15%-20%</td> <td>34</td> <td>18.9%</td> </tr> <tr> <td>B. LËNDË KARAKTERIZUESE</td> <td>50%- 55%</td> <td>96</td> <td>53.3%</td> </tr> <tr> <td>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE</td> <td>12%-15%</td> <td>26</td> <td>14.4%</td> </tr> <tr> <td>D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)</td> <td>10%- 15%</td> <td>18</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE</td> <td>3%- 5%</td> <td>6</td> <td>3.3%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në syllabuset e lëndëve paraqitet qartë ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar).</p> <i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit] [Vizita në Institucion: Shenime ne vizite]</i>			Kategoria	Përqindja Krediteve Sipas VKM	Programi		Kredite	Përqindje	A. LËNDË BAZË	15%-20%	34	18.9%	B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 55%	96	53.3%	C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-15%	26	14.4%	D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%- 15%	18	10%	E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	3%- 5%	6	3.3%
Kategoria	Përqindja Krediteve Sipas VKM	Programi																											
		Kredite	Përqindje																										
A. LËNDË BAZË	15%-20%	34	18.9%																										
B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 55%	96	53.3%																										
C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-15%	26	14.4%																										
D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%- 15%	18	10%																										
E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	3%- 5%	6	3.3%																										

<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton e shprehur qartë shpërndarja e krediteve në gjashte semestra dhe për secilën lëndë apo veprimtari brenda programit. Programi i studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” rezulton me 30 kredite për semestër, 60 kredite në një vit të plotë akademik dhe tre vite akademike.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit] [Evidenca Nr.23, Plani Mesimor]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuencimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ konstaton se plani mësimor përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Frekuencimi ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit dhe syllabuset. Në syllabuset e lëndëve, jepet informacion në lidhje me temat mësimore në leksione dhe në seminarëve, orët faktike për secilën prej temave, detyrimet lidhur me lëndën, etj. Frekuencimi / ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit] [Syllabus 2020-2021]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Rregullorja e programit të studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” përmban të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit]</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se syllabuset e lëndëve janë të paraqitur në strukturë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi. Programet lëndore hartohen nga titullari i lëndës, sipas modelit të paraqitur në VKM nr. 41, dt. 24.01.2018. Në fillim të çdo semestri pedagogu i njeh studentët me programin lëndor dhe veprimtaritë e përfshira në të, me detyrimet dhe përgjegjësitë, me format e vlerësimit dhe provimin final.</p> <p><i>[Syllabuset 2020-2021] [VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018; VKM Nr.879, date 18.12.2019]</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ konstaton se stafit akademik i kërkohet të përditësojë syllabuset në fillim të vitit akademik. Sipas RVB, programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme.</p> <p><i>[Syllabuset 2020-2021]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<input checked="" type="checkbox"/>

**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																												
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se programi studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” është i organizuar në 3 vite akademike, me 180 kredite në total ose 60 ECTS/vit. Programi ka 30 lëndë, të kategorizuara si lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse. Siç e kemi përmendur, konstatohet se ky organizim është bërë në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi (VKM 41). Ndarja e orëve mësimore është si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti akademik</th> <th colspan="3">Mësim në auditor dhe terren</th> <th rowspan="2">Total orë/ (120)</th> </tr> <tr> <th>Auditor</th> <th>Studim individual</th> <th>Praktika profesionale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Viti I</td> <td>615</td> <td>885</td> <td>-</td> <td><b>1500</b></td> </tr> <tr> <td>Viti II</td> <td>615</td> <td>885</td> <td>-</td> <td><b>1500</b></td> </tr> <tr> <td>Viti III</td> <td>495</td> <td>885</td> <td>120</td> <td><b>1500</b></td> </tr> <tr> <td><b>Total</b></td> <td><b>1725</b></td> <td><b>2655</b></td> <td><b>120</b></td> <td><b>4500</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>[Evidenca Nr.23, Plani Mesimor]</p>	Viti akademik	Mësim në auditor dhe terren			Total orë/ (120)	Auditor	Studim individual	Praktika profesionale	Viti I	615	885	-	<b>1500</b>	Viti II	615	885	-	<b>1500</b>	Viti III	495	885	120	<b>1500</b>	<b>Total</b>	<b>1725</b>	<b>2655</b>	<b>120</b>	<b>4500</b>
Viti akademik	Mësim në auditor dhe terren			Total orë/ (120)																									
	Auditor	Studim individual	Praktika profesionale																										
Viti I	615	885	-	<b>1500</b>																									
Viti II	615	885	-	<b>1500</b>																									
Viti III	495	885	120	<b>1500</b>																									
<b>Total</b>	<b>1725</b>	<b>2655</b>	<b>120</b>	<b>4500</b>																									
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se emërtimi i programit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” është në përputhje me fushën akademike të tij. Përmbajtja e veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike.</p> <p>Në lidhje me sa më lart, GVJ vlerëson se ky program studimi mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike, një element mjaft i rëndësishëm ky për t’u përballur me tregun e punës pas diplomimit të tyre apo thellimit të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme.</p>																												
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se mundësohet arritja e objektivave formues të programit të studimit në Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” dhe rezultateve të pritshme të të nxënit, aftësimin profesional dhe kërkimit shkencor. Në vitin e I zhvillohen kryesisht lëndët bazë, ndërsa në vitin II dhe III zhvillohen lëndët karakterizuese, ndërdisiplinore dhe përmbyllëse. Kjo mundëson që baza teorike e lëndëve të formimit bazë të shërbejë në përvetësimin më të mirë të dijeve prej lëndëve me karakter profesional.</p> <p>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit të Studimit] [Evidenca Nr.23, Plani Mesimor]; Syllabus 2020- 2021] [Vizita në Institucion]</p>																												
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se lëndët janë në përputhje me profilin e programit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” dhe rjedhimisht, të domosdoshme për formimin e specialistëve në këtë fushë studimi.</p> <p>Nga vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit. Lëndët janë të organizuara në aktivitete formuese Leksion/Ushtime (seminar). Në secilën prej tyre ka aktivitete formuese teorike dhe praktike</p>																												

	<i>Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit] [Evidenca Nr.23, Plani Mesimor]; Syllabus 2020-2021] [Vizita në Institucion]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Gjatë intervistave më personelin akademik dhe me studentët evidentohet se raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe formimin e specialistëve të aftë në fushën e inxhinierisë elektrike. Sasia e orëve në auditor për përgatitjen praktike (Seminare, laboratorë, projekte praktikë, etj) është 891 orë, nga 954 orë totale për përgatitjen teorike (orët e leksioneve), ose orët në auditor për përgatitjen praktike zënë rreth 51% të orëve totale në auditor. GVJ gjykon që raporti i tyre është në përputhje me ciklin e parë të studimeve.  <i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit] [Evidenca Nr.23, Plani Mesimor]; Syllabus 2020-2021] [Vizita në Institucion]</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion GVJ konstaton se syllabuset rishikohen në fillim të vitit akademik për të futur literaturat e reja, të cilat duhet të jenë të 5 viteve të fundit. Disa nga literaturat në sylabuset nuk janë të 5 viteve të fundit. Hapat tepër të shpejtë të zhvillimit të disiplinave inxhinierike duhet të shoqërohen me një literaturave përkatëse bashkëkohore.  <i>[Syllabus 2020-2021]</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	GVJ konstaton, bazuar në lëndët e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përkatëse, se programi i studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli Bachelor. Ka lëndë që përfshihen në këtë program dhe që garantojnë përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi.  <i>[Evidenca Nr.23, Plani Mesimor]; Syllabus 2020-2021]</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” u jep mundësi studentëve të pozicionohen në karrierën e tyre të ardhshme profesionale. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se, programi i studimit duke kombinuar teorinë me praktikën siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional në fushën e Shkencave të Inxhinierisë Elektrike.  <i>[Evidenca Nr.23, Plani Mesimor]; Syllabus 2020-2021]</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Përpara hapjes së programit të studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” është kryer një analizë të tregut të punës e cila u përdor për krijimin e përmbajtjes së programit të studimit. Përmbajtja e programit të studimit synon të mundësojë punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmërinë dhe kërkesat e tregut e punës. Në vijimësi, NJSBC dhe DIEE konsultohen me bashkëpunëtorët prej biznesit e tregut të punës në lidhje me trendet e reja të fushës së inxhinierisë elektrike dhe përipiqen të bëjnë përditësimet tek programet e studimit. Nuk ka evidencë që e vërtetojnë këtë me aktivitete konkrete, por kjo filozofi shihet e shprehur tek numri i lartë i drejtimeve që ka ky program studimi.  <i>[Evidenca Studimi për tregun e punës.]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<input checked="" type="checkbox"/>

**Standardi II.5**

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për programin Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” për gjatë tre viteve të fundit akademike janë si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="638 459 1420 795"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Viti Akademik 2018-2019</th> <th colspan="2">Viti Akademik 2019-2020</th> <th colspan="2">Viti Akademik 2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>0</td> <td>2</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Prof.Assoc</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>3</td> <td>6</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej</b></td> <td><b>7</b></td> <td><b>16</b></td> <td><b>8</b></td> <td><b>5</b></td> <td><b>9</b></td> <td><b>9</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Modulet mësimore në programin e Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” mbulohe nga pedagogë të cilët kanë gradë shkencore. Bazuar në dokumentacion stafi në këtë program studimi është si në tabelën më sipër.</p>	Kualifikimi i stafit	Viti Akademik 2018-2019		Viti Akademik 2019-2020		Viti Akademik 2020-2021		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1	3	3	0	2	0	Prof.Assoc	2	4	2	2	2	2	Dr/PhD	3	6	1	2	1	2	Msc	1	3	2	1	4	5	<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>16</b>	<b>8</b>	<b>5</b>	<b>9</b>	<b>9</b>
Kualifikimi i stafit	Viti Akademik 2018-2019		Viti Akademik 2019-2020		Viti Akademik 2020-2021																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof.Dr	1	3	3	0	2	0																																											
Prof.Assoc	2	4	2	2	2	2																																											
Dr/PhD	3	6	1	2	1	2																																											
Msc	1	3	2	1	4	5																																											
<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>16</b>	<b>8</b>	<b>5</b>	<b>9</b>	<b>9</b>																																											
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Nga verifikimi i personelit akademik i përfshirë në mësimdhënie, GVJ konstaton një paqëndrueshmëri në stafin akademik PAK, pasi secili vit akademik ka ndryshime të shumta në angazhimet e tij . Ngarkesa mësimore për personelin akademik me kohë të plotë dhe personelit akademik me kohë të pjesshme në programin e studimit është si në tabelën më poshtë.</p> <p>Nga verifikimi i të dhënave statistikore, u konstatua se për tre vitet mbi 70% e ngarkesës mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv, PAE. Konkretisht:</p> <p><i>Për Vitin akademik 2018-2019, të dhënat janë të pjesshme, vetëm për vitin I. Për vitin akademik 2019-2020 ka mungesë të dhënash për lëndën “ Hyrje në shkencat Kompjuterike” . Për vitin akademik 2020-2021, tabela e ngarkesës mësimore është plotësuar gabim, pasi për shumë pedagogë është vendosur ngarkesa totale e tyre si ngarkesë e lëndës , duke e shumëfishuar artificialisht ngarkesën. Keto tabela duhen riplotësuar Kërkesa ligjore që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% te ngarkesës, nuk mund të vlerësohet saktë nga të dhënat e tabelave edhe pse duke hamëndësuar nga përfshirja e stafit PAE dhe PAK në lëndë të ndryshme, duket se përmbushet.</i></p> <p><i>Kategoria profesor ka një ngarkesë vjetore të lartë për këtë kategori.</i></p> <p><i>[Evidenca Personeli akademik në programin studimit] [Evidenca Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik]</i></p>																																																
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se personeli akademik i programit ka njohuri në përputhje me natyrën e programit. Rezulton se personeli akademik i programit është i specializuar në fusha specifike të</p>																																																




programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	<p>cilat mbulojnë në të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, gjë që garanton formimin e specialistëve të fushës me aftësi të larta.</p> <p>[CV Emër Mbiemër]</p>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>“Universitetit Metropolitan Tiranë” ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e institucione të sektorit publik. Procedura e zhvillimit të praktikave profesionale është e rregulluar nëpërmjet udhëzuesit për zhvillimin e praktikës në të cilën përcaktohet dhe përgjegjësia për ecurinë e praktikave profesionale. Në fund të praktikës së realizuar nga studenti plotësohet dosja e saj e cila përmban gjithashtu të dhëna lidhur me pedagogun udhëheqës/ pritës dhe përshkrimin e udhëheqesit për praktiken e kryer nga studenti.</p> <p>[Evidenca Nr. 56- Lista e kompanive me te cilet institucioni ka marreveshje bashkepunimi][Evidenca 82 -Rregullore e temes se Diplomes] [Evidenca Nr.81- rregullore per udheheqjen e diplomave]</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<p>Gjatë vizitës në ambientet e shkollës (klasat /laboratorët ku bëhet mesim nga studentet e këtij programi) GVJ konstatoi se mirëmbajtja e laboratorëve kryhej prej stafi mbështetës. Nga intervistat me stafin akademik dhe studentët GVJ konstatoi se pedagogët e lëndës realizojnë dhe anën praktike të saj (laboratorët). Nga shqyrtimi i CV-ve stafi akademik është i përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike</p> <p>[Vizita në Institucion] [CV Emër Mbiemër].</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<input checked="" type="checkbox"/>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<input checked="" type="checkbox"/>	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se “Universiteti Metropolitan Tirana” në nivel institucional ka hartuar udhëzuesin për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve. Karakteri inxhinierik i programit të studimit sugjeron ndërthurjen e trajtimit teorik me zbatimin praktik përmes përdorimit të softeve inxhinierike dhe laboratoreve. Në mbështetje të kësaj objekteve, UMT ka krijuar laboratore me kompjutera si dhe ka pajisur studentët me laptop

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	-e me softë të nevojshme të instaluara.			
	<i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit të Studimit]</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	GVJ konstaton se një nga objektivat strategjik të “Universitetit Metropolitan Tiranë” është “Cilësia dhe performanca Akademike”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se strukturat përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. NJSBC që funksionon në nivel IAL, ka si detyrë ndjekjen në vazhdimësi të treguesve të cilësisë, të cilët i vlerëson mbi bazë të një pyetsori me shumë rubrika dhe mbi rezultatet e të cilit formulon një raport ku evidentohen problemet që shohin studentët në procesin e realizimit të programit të studimit.  <i>[Evidenca Nr. 12, Pyetesori i studenteve për mesimdhënien online]</i> <i>[Evidenca Nr.21, Raporti mbi rezultatet e pyetesorit me studente UMT 2021]</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GVJ konstaton se institucioni përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies duke ju dhënë mundësi atyre të plotësojnë pyetësorë përpara përfundimit të çdo semestri. NJSBC ka hartuar raport të detajuar në lidhje me rezultatet e pyetesorëve dhe shprehet se kur ka pasur ankime ato janë trajtuar.  <i>[Evidenca Nr. 12, Pyetesori i studenteve për mesimdhënien online]</i> <i>[Evidenca Nr. 26, Rregullorja e Provimeve]</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është struktura përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore në “Universitetit Metropolitan Tiranë”. Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Ai vlerëson performancën e personelit akademik me anë të formularit të vlerësimit. NJSBC analizon, mbi bazën e metodave statistikore, vlerësimet e cilësisë së mësimdhënies dhe gjeneron një raport individual për secilin anëtar të stafit akademik. Raporti komunikohet tek autoritetet drejtuese të “Universitetit Metropolitan Tiranë”. Ky raport i shkon gjithashtu përgjegjësit të njësisë bazë, i cili vë në dijeni të vlerësimit të bërë nga studentët në mënyrë konfidenciale personelin akademik.  <i>[Evidenca no 01: Statuti UMT]</i> <i>[Evidenca 12, Pyetesori i studenteve për mesimdhënien online]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	GVJ, në bazë të dokumentave konstaton se rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmbledhen në një raport. Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. NJSBC përgatit raportin e vlerësimeve periodike dhe i vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuar.  <i>[Evidenca 12, Pyetesori i studenteve për mesimdhënien online]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<input checked="" type="checkbox"/>

**Standardi III.2**

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																				
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ konstaton se personeli akademik i programit zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale. Syllabuset e lëndëve miratohen në department.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit të Studimit] Syllabus 2020-2021] [Vizita në Institucion]</i></p>																				
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Ciklit të Parë Bachelor "Inxhinieri Elektrike" merr pjesë në trajnimet e orientuara në aspektet didaktike të mësimdhënies të organizuara nga "Universitetit Metropolitan Tiranë". Gjithashtu gjatë punës me studentët ata nxiten të përdorin metoda inovative të mësimdhënies Personeli akademik merr në konsideratë nevojat e studentëve dhe bashkëpunon me ta për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie-mësimnxënie sa më të mirë.</p> <p><i>[Vizita në Institucion]</i></p>																				
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>GVJ konstaton se "Universitetit Metropolitan Tiranë" angazhohet për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit të tij akademik. GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit të studimit studimit Ciklit të Parë Bachelor "Inxhinieri Elektrike" mundësojnë për personelin akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike.</p> <p>UMT ka gjithashtu marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të Erasmus + KA-107 me 19 universitet rajonale dhe Evropianë. Ne kuadër të mobiliteteve ka shkëmbime me universitetet në Letoni, Poloni, Çeki, Rumani kryesisht për studime dhe mësim dhënie në shkencë kompjuterike dhe në Inxhinieri software.</p> <p><i>[Vizita në Institucion] [Evidenca 65. Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të shkëmbimit-mobilitetit]; [ Evidenca 66 Lista e shkëmbimeve në kuadër të Erasmus+]</i></p>																				
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ pas analizimit të CV-ve të personelit akademik konstaton se personeli akademik i programit të studimit Ciklit të Parë Bachelor "Inxhinieri Elektrike" zotëron përgatitje dhe kompetenca profesionale në mësimdhënie dhe në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve.</p> <table border="1" data-bbox="587 1532 1024 1861"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Viti Akademik 2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Prof.Assoc</td> <td>2</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>4</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej</b></td> <td><b>9</b></td> <td><b>9</b></td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi i stafit	Viti Akademik 2020-2021		PAE	PAK	Prof.Dr	2	0	Prof.Assoc	2	2	Dr/PhD	1	2	Msc	4	5	<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>9</b>
Kualifikimi i stafit	Viti Akademik 2020-2021																				
	PAE	PAK																			
Prof.Dr	2	0																			
Prof.Assoc	2	2																			
Dr/PhD	1	2																			
Msc	4	5																			
<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>9</b>																			



	<p>Ne Aneksi 16 [Evidenca 16 - Personeli Akademik i Departamentit] janë 8 personel PAE dhe 13 personel PAK të referuara.</p> <p>Nga anketimi i studenteve lidhur me procesin mësimor gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020 -2021 ku morën pjesë 54.3 % e studentëve të FSHKIT 59 % e studentëve shprehën të kënaqur me metodën e shpjegimit të pedagogëve. Përsa i përket mënyrës së komunikimit të pedagogut gjatë orës së mësimi studentët janë të ndarë në dy grupe kryesore. Rreth 39 % janë të mendimit se pedagogët e të gjitha lëndëve shpjegojnë qartë dhe kuptueshëm ndërsa pjesa tjetër, rreth 58 %, deklarojnë se kjo është e vërtetë vetëm për disa lëndë.</p> <p>[Evidenca 21. Raporti mbi rezultatet e pyetësorit] [CV Emër Mbiemër]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se format e metodat e mësimdhënies vlerësohen nga eprori dhe studentët, kjo nëpërmjet komunikimit direkt me pedagogun apo përgjegjësin e njësisë bazë, mendime që shprehen nga përfaqësuesi i studentëve në mbledhje të njësisë bazë etj.</p> <p>Pyetësorët e hartuar në mënyrë periodike janë një mënyrë tjetër vlerësimi për metodat e mësimdhënies.</p> <p>Nga anketimi i studentëve 73 % e studentëve pohojnë se pedagogët janë të hapur për pyetje në të gjitha lëndët dhe rreth 93 % e tyre kanë mundur të bëjnë pyetje në një apo të gjitha lëndët. Po ashtu 94- 96 % e studentëve pohojnë se janë përfshirë në diskutime, zgjidhjen e ushtrimeve apo kanë zgjidhur detyra apo teste on-line në një apo të gjitha lëndët.</p> <p>[Vizita në Institucion], [Evidenca 21. Raporti mbi rezultatet e pyetësorit]</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion. takimi me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se personeli akademik përdor metoda interaktive duke i bërë tërheqëse orët e mësimi. Këto metoda përfshijnë simulime, video, detyrë kursi, diskutime, prezantime etj.</p> <p>[Vizita në Institucion]</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik është inkurajuar nga “Universitetit Metropolitan Tiranë” të zbatojë mësimdhënien me në qendër studentin, e cila krijon mundësi që studentët të ndërtojnë vetë dijet duke ndërvepruar dhe punuar në mënyrë të pavarur, ndërsa pedagogët e programit të shndërrohen në mbështetës të procesit mësimor.</p> <p>[Vizita në Institucion]</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				☒

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave të hapësirave vlerëson se procesi mësimor e shkencor i programit të studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” realizohet në hapësira të mjaftueshme, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p> <p>Sipas tabelës përmbledhëse ofruar nga Universiteti “Metropolitan Tirana”, godinat ku zhvillohet mësimi për FSHKIT ka sipërfaqe totale 2250m<sup>2</sup> dhe ka një numër total prej 162 studentësh që zhvillojnë mësimin në këtë godinë, për të gjitha programet e studimit që mbuloohen nga FSHKIT. Si rrjedhim, koeficienti i përdorimit të ambienteve të FSHTN prej studentëve të tij është <math>2250/162 = 13.88 \text{ m}^2/\text{student}</math>. Bazuar në VKM 418 datë 10/05/2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• IAL me drejtim Shkencat e Natyrës ky koeficient është 2.5</li> <li>• IAL me drejtim Inxhinieri e Teknologji, ky koeficient është 5.</li> </ul> <p>Pra mund të themi se kapacitet e ambienteve të shfrytëzueshme për studentët plotësisht të mjaftueshme për zhvillimin e mësimit , madje janë me rezervë duke mundësuar rritje të numrit të studentëve.</p> <p><i>[[Evidenca Nr. 30- Asetet Infrastrukturore, akademike UMT] [Vizita në Institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës së ambienteve të dedikuara për procesin mësimor, konstaton se klasat dhe laboratorët mësimore janë të pajisur me kompjutera dhe projektorë.</p> <p>Mjediset e klasave, auditorëve, laboratorëve etj, ku zhvillohet mësimi, janë të pajisura me kompjuterë, video projektorë, tabela interaktive e internet. Përgjithësisht mësimi zhvillohet i kombinuar: sipas mënyrës tradicionale dhe metodave që përdorin teknologjinë bashkëkohore për rritjen e efektivitetit të mësimdhënies e mësim nxënies.</p> <p>Ambientet e bibliotekave kanë kapacitet të mjaftueshëm . Biblioteka ka kushte të mira, pajisur me literature, kompjutera dhe me orar të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për studentët.</p> <p>Biblioteka ka kryesisht tekste mësimore dhe literature ndihmëse në gjuhë shqip (21 tituj) dhe të huaj : anglisht 48 tituj, italisht 1 titull, por ato konsiderohen të pamjaftueshme për studentët e programit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike”. Fondi i saj nevojitet të pasurohet me tituj të rinj dhe revista teknike bashkëkohore, me qëllim mbështetjen e studentëve në punën kërkimore për detyrat e kursit në lëndët e formimit profesional dhe diplomat. Literatura e vlefshme për studentët e inxhinierisë elektrike në bibliotekë është relativisht e ulët me gjithë përpjekjet që UMT bën për mirëmbajtjen e tyre.</p> <p>Në bibliotekën e FSHKIT ka gjithsej rreth 70 tituj, por titujt në dispozicion të studentëve të inxhinierisë elektrike nuk specifikohen dhe konsiderohet i pamjaftueshëm. Literaturata në gjuhën shqip është kryesisht tekst mësimor.</p> <p><i>[Evidenca Nr.70, Lista e Laboratorëve ne funksion te programit te studimit)] [Vizita në Institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>UMT ka në shfrytëzim platformën elektronike “edu4school” i cili u ofron përdoruesve (student e pedagogë) marrje informacionesh si : orari, rezultate provimesh, njoftime etj. Kjo platformë aksesohet me username e password nga secili anëtar i UMT nëpërmjet adresës personale te emailit te vene ne dispozicion nga UMT. Platforma “gotomeeting” ofron disa shërbime si: e-learning (marrje materialesh prej pedagogëve), zhvillim</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>mësimi online, dorëzime detyrash , komunikim interaktiv student-pedagog përmes hapësirës së dedikuar që ka secili student në këtë platformë.</p> <p><i>[Vizita në Institucion] [Evidenca 20. Udhëzues i teknologjisë]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe e rekomanduar mbi të cilat organizohet dhe mbështetet procesi mësimor në “Universitetit Metropolitan Tiranë” garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme në fushën inxhinierisë elektrike. Literatura e pakte është e ruajtur fizikisht në bibliotekë. Literatura në gjuhën angleze është në formë elektronike. Biblioteka ka kryesisht tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqip (21 tituj) dhe të huaj : anglisht 48 tituj, italisht 1 titull, por ato konsiderohen të pamjaftueshme për studentët e programit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike”.</p> <p><i>[Vizita në Institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Literatura ruhet fizikisht në bibliotekë. Të gjithë lektorët mund të propozojnë titujt, që mund të shtohen në bibliotekë. Biblioteka ka kryesisht tekste mësimore dhe literature ndihmëse në gjuhë shqip (21 tituj) dhe të huaj : anglisht 48 tituj, italisht 1 titull, por ato konsiderohen të pamjaftueshme për studentët e programit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike”</p> <p><i>[Vizita në Institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB, personeli akademik dhe studentët ciklit të dytë studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” aksesojnë librarinë online në të cilën gjenden të listuara libra dhe artikuj që lidhen me lëndët e trajtuara në këtë program studimi.</p> <p><i>[Vizita në Institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik dhe studentët në “Universitetit Metropolitan Tiranë” përdorin platformat GotoMeeting dhe Edu4School</p> <p>DIEE ka në dispozicion të studentëve 4 laboratore me disa module, ku zhvillohen seancat laboratorike. Nga takimi me përgjegjësën e departamentit u konfirmua se Universitetit “Metropolitan Tirana” dhe FSHKIT vazhdon të ketë në vëmendje mundësinë e ngritjes së laboratorëve të reja për lëndë të karakterit profesional, duke e konsideruar këtë aspekt si një ndër pikat e forta të saj .</p> <p><i>[Vizita në Institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik dhe studentët në përdorin platformat GotoMeeting dhe Edu4School. Kjo platformë është konfiguruar dhe përshtatur në vitin akademik.</p> <p><i>[Vizita në Institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>“Universitetit Metropolitan Tiranë” ka vënë në dispozicion llogari ne GotoMeeting dhe Edu4School dhe i ofron studentëve dhe personelit akademik hapësirë vetjake të dedikuar në të cilën mund të ruhet dokumentacioni elektronik si dhe mundësinë e komunikimit elektronik nëpërmjet postës elektronike.</p>

	<p>Sistemi i brendshëm është me karakter modular dhe ka të integruar platformën GotoMeeting dhe Edu4School që mundëson e-learning dhe komunikim interaktiv të studentëve e pedagogëve, për shkëmbim materialesh mësimore në format pdf, si dhe dorëzimin e detyrave të studentëve. Në faqen web të UMT gjendet edhe manuali i përdorimit të kësaj platforme.</p> <p><i>[Vizita në Institucion]</i></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Stafi akademik ne programin e studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” mbështet studentët në përzgjedhjen e temave dhe hartimin e tyre. Bazuar në fushën e ekspertizës së pedagogëve të programit studentët zgjedhin udhëheqësin. Në bashkëpunim me udhëheqësin zgjedhin temën me të cilën do të punojnë.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit të Studimit]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<input checked="" type="checkbox"/>

<p><b>Standardi III.4</b>  <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>“Universitetit Metropolitan Tiranë” në statutin e tij ka përcaktuar Njesinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore. NJBSC planifikon dhe organizon Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë, në kuadër të “Universitetit Metropolitan Tiranë</p> <p>NJBSC bashkëpunon për çdo vlerësim të brendshëm të cilësisë që organizon. Rezultatet e Raporteve të vlerësimit të NJBSC shërbejnë si bazë për të hartuar dhe zbatuar programe të zhvillimit pedagogjik dhe didaktik të personelit akademik.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 85 Manuali i Sigurimit të Cilësisë të UMT]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të cilësisë në çdo fakultet janë përgjegjëse për procesin e vetëvlerësimit dhe për implementimin e plan veprimeve për sigurimin e cilësisë në kuadër të aktiviteteve që ato kryejnë. Grupi i vlerësimit të brendshëm është ngritur me urdhër të dekanit të njësisë kryesore dhe përgjegjësit të departamentit ku zhvillohet programi.</p> <p>Departamenti bën analiza periodike, mbi bazën e të cilave shqyrton situatën e përmbushjes së standardeve të cilësisë së mësimdhënies, duke lënë detyra për zgjidhjen e problematikave të mundshme.</p> <p>Vetëvlerësimi i cilësisë së programit të studimit bëhet duke marrë edhe mendimin e studentëve, kryesisht përmes pyetësorëve që UMT organizon 2 herë në vit në lidhje me procesin mësimor dhe aspekte të tjera të jetës studentore në këtë institucion.</p> <p><i>[Evidenca Urdhër për ngritjen e GVB]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e</p>	<p>“Universitetit Metropolitan Tiranë” ka një vizion strategjik për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Nga biseda me stafin akademik dhe studentët u</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

metodave të reja inovative të mësimdhënies.	konfirmua se përgjithësisht mësimdhënia tradicionale kombinohet me veprimtari ushtrimore si aplikimi përmes softwareve i koncepteve teorike. Infrastruktura e përshtatshme e mundësuar prej UMT e bën këtë gjë të arritshme.  <i>[Vizita në Institucion]</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ konstaton se “Universitetit Metropolitan Tiranë” mbështet kualifikimin në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor, <b>Mbetet shqetësim numri i ulët i pjesëmarrjes së stafit akademik PAE në konferenca ndërkombëtare dhe botimeve shkencore. Nga tabela 20 e Aneksit, shihet se ka vetëm 1 pjesëmarrje në aktivitete shkencore jashtë IAL dhe asnjë leksion të hapur nga lektorë të huaj.</b>  <i>[Vizita në Institucion]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Në udhëzuesin strategjik për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies “Universitetit Metropolitan Tiranë” ka planifikuar fushat e zhvillimit profesional të stafit akademik. Nuk ka evidencë që janë zhvilluar trajnime për rritjen e cilësisë së mësimdhënies së stafit akademik.  <i>[Vizita në Institucion]</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik ka realizuar me sukses programin e studimit. Ata angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies duke marrë pjesë në trajnime të organizuar nga institucioni dhe marrë në konsideratë rekomandimet e studentëve. Personeli akademik përdor metoda inovatove në realizimin e tij, si p. sh. Simulimet.  <i>[Evidenca Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit]</i> <i>[Vizita në Institucion]</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacioneve dhe takimit me personelin akademik konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmërinë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. Departamenti i Inxhinierise Elektrike dhe Elektronike nxit dhe mbështet stafin akademik.  <i>[Evidenca Analizë e Departamentit përgjegjës për programin e studimit]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<input checked="" type="checkbox"/>	

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e programit.  Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm:

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 5% niveli i diskutimit në seminare</li> <li>- 25% detyrë kursi</li> <li>- 10% provimi i ndërmjetëm</li> <li>- 60% provimi përfundimtar</li> </ul> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit] [Syllabus 2020-2021] [Evidenca Nr.26, Rregullore e Provimeve]</i></p>								
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Nga takimi me studentët GVJ konstaton se personeli akademik, në fillim të çdo lënde informon studentët për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore dhe atë të programit.</p> <p><i>[Vizita në Institucion]</i></p>								
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë: Provimi i ndërmjetëm, Niveli i pjesëmarrjes në seminare , Detyra e kursit (projekte), Provimit përfundimtar.</p> <p><i>[Evidenca 02 Rregullore e Brendshme e UMT,] [Syllabus 2020-2021] [Evidenca 04, Rregullore e Programit te Studimit]</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">☒</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				☒
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			☒						

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>GVJ ka shqyrtuar rregulloren e programit të studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” dhe ka konstatuar se në rregulloren e tij është përcaktuar se si realizohet testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Testimi dhe vlerësimi në “Universitetit Metropolitan Tiranë” është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale me mjetet elektronike</p> <p><i>[RVB] [Vizita në Institucion]</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se “Universitetit Metropolitan Tiranë” ka përcaktuar në rregullore modalitetet për miratimit të komisioneve të provimeve dhe të mbrojtjes së diplomave, Përgjegjësi i Departamentit miraton modalitete të vlerësimit dhe ngre komisionet e provimeve të cikleve përkatëse të studimeve në lëndët që mbulon departamenti. Sipas RVB komisionet e provimeve kanë së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës.</p>

	<i>[Evidenca Nr.26, Rregullore e Provimeve]</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	GVJ konstaton se provimet me shkrim sekretohen nga personeli i Sekretarisë Mësimore. Korigjimi kryhet në anonimitet duke mundësuar barazi midis studentëve dhe vlerësimin sipas meritës. Takimi me studentët e konfirmoi këtë.  <i>[Evidenca Nr.15, Rregullore e Sekretarisë Mesimore] [Evidenca Nr.26, Rregullore e Provimeve]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Sipas RVB, vlerësimi i komponentëve të vlerësimit shoqërohet me komente nga pedagogu. Një seancë sqaruese zhvillohet pas testit. Në të qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin dhe cilesinë e punimeve të tyre. Edhe në takimin me studentët u konfirmua se procedura e kontrollit të dijeve dhe dhënia e rezultateve bëhet kryesisht sipas rregullores së DIEE dhe nga ana e studentëve nuk u evidentuan problematika që mund ta dëmtonin procesin.			
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Sipas RVB, të gjitha detyrat e kursit dhe projektet kontrollohen për plagjiaturë. Testet e ndërmjetme dhe ai final administrohen nga prania në auditor e dy pedagogëve, të cilët janë përgjegjës për moslejimin e kopjimit.  <i>[Evidenca Nr. 31, Rregullore e Etikes]</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se “Universitetit Metropolitan Tiranë” ka përcaktuar se dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet jo më vonë se 3-5 diteve nga data e zhvillimit të tyre. Rezultatet e kontrollit të dijeve merren pasi korigjohen provimet me shkrim dhe merret parasysh edhe ecuria e studentit gjatë semestrit, sipas pikëve të përcaktuara në syllabus (frekuentimi, pjesëmarrja në diskutime, performanca në kryerjen e detyrave etj).  <i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit të Studimit]</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se në rregulloren e Universitetit përcaktohet e drejta e studentit për ankimin e rezultateve të provimit.  <i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit të Studimit]</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	GVJ konstaton se në rregulloren përcaktohet se ankimimi i studentit i dërgohet Dekanit përkatës dhe ai ngrë një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të përgjegjës të departamentit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. <i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit të Studimit]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<input checked="" type="checkbox"/>

### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentëve, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Mbështetur në rregulloren e programit të studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” GVJ konstaton se synohet formimi i ekspertëve dhe specialistëve në nivel cilësor në fushën e inxhinierisë elektrike. Bazuar në kurrikulën e tij dhe në syllabus-et e lëndëve të veçanta, ky program zhvillon dijet e studentëve dhe avancimin e tyre teknik e profesional në fushën e inxhinierisë elektrike . Veprimtaritë formuese zhvillohen prej 30 lëndëve, grupohen në 5 kategori : lëndë bazë 18.88%, lëndë karakterizuese 53.33%, ndërdisiplinore 12.22% , plotësuese 10% dhe përmbyllëse 3.33%. Pra, zhvillimi i programit të studimit bëhet konform VKM 41 dhe mundëson marrjen e njohurive në mënyrë të balancuar dhe që lejon aftësimin profesional të studentit.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit][Evidenca Nr.23, Plani Mesimor] [Syllabus 2020-2021;]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” zhvillon aftësi të veçanta në fushën e inxhinierisë elektrike përmes lëndëve karakterizuese sipas drejtimeve që ka programi i studimit. Në programin lëndor ka dhe lëndë me zgjedhje të karakterit profesional për ta arritur këtë. Programi synon gjithashtu zhvillimin e aftësive të respektimit të parimeve etike dhe humane të zbatimit te inxhinierisë elektrike.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Departamenti Departamenti i Inxhinierise Elektrike dhe Elektronike analizon kompetencat profesionale të fituara nga studentët dhe i paraqet ato në: Analizën vjetore të tij, mbi arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional në programin e studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike”.</p> <p><i>[Evidenca Analizë e Departamentit përgjegjës per programin e studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Sipas RVB dhe informacionit të marrë gjatë vizitës, përpara testit ndërmjetës dhe përpara testit final pedagogët bëjnë një përmbledhje të njohurive kryesore të trajtuara dhe orientojnë studentët mbi strukturën e testit ndërmjetës dhe atij final. Pedagogët perfshijnë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” është angazhuar edhe në veprimtari të tjera, si konferenca (seminare) të ndryshme, ku kanë prezantuar edhe teknologji të ndryshme në auditore të zgjeruara ku marrin pjesë jo vetëm studentet e programit të studimit por edhe studente dhe pedagoge nga programe të ndryshme studimi të fakulteteve të tjera.</p> <p><i>[Vizita në Institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>GVJ vlerëson se personeli akademik transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer ekspertiza laboratorike. Gjate zhvillimit të orëve mësimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi dhe projekte të ndryshme në fushën e inxhinierisë elektrike.</p>



	<i>[Vizita në Institucion]</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Sipas RVB dhe në bazë të vizitës së GVJ në institucion, personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyra e kursit në lëndët përkatëse është një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup.			
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Përgjithësisht temat e detyrave të kursit janë raste studimi reale, në të cilat personeli akademik nxit studentët që ta trajtojnë studimin dhe ofrimin e zgjidhjes së problemeve duke u organizuar në skuadër. Detyrat e kursit pjesë e programeve mësimore të çdo lëndë mbështesin e zhvillojnë ide inovative.			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	“Universitetit Metropolitan Tiranë” mbështet idetë inovatore të studentëve, krijon mundësi për zbatime të avancuara dhe mbështet financiarisht projekte kërkimore të suksesshme.  <i>[Syllabus 2020 2021 [Evidenca Nr.03, Strategjia e Zhvillimit të UMT”] [Vizita në Institucion]</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ ka konstatuar se “Universitetit Metropolitan Tiranë” implementon disa projekte ERASMUS. Nëpërmjet tyre institucioni mundëson rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe perfitimim prej praktikave më të mira të institucioneve bashkëpunuese perëndimore, njohuri të cilat më pas aplikohen në auditor apo transferohen tek anëtarë të tjerë të personelit akademik.  <i>[Evidenca Nr. 43, Udhëzues për planin e mobilitetit për stafin akademik në kuadër të Erasmus+][Evidenca Nr. 57-Lista e marreveshjeve Erasmus+][ Evidenca 66 Lista e shkëmbimeve në kuadër të Erasmus+]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<input checked="" type="checkbox"/>

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	“Universitetit Metropolitan Tiranë” ka hartuar një rregullore diplomimi. Dokumenti udhëzues mbi punimin e diplomës, jep në mënyrë të detajuar çdo procedurë që ndiqet për temën e diplomës. Studentet me mesatare të ponderuar mbi 8 mund të pezgjedhin zhvillimin e temës së diplomës ndërsa studentet që nuk e arrijnë këto mesatare zhvillojnë një provim final.  <i>[Evidenca Nr.81- rregullore për udhëheqjen e diplomave]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion	DIEE angazhon stafin akademik të orientojnë studentët në procesin e përmbylljes së studimeve. Kjo bëhet duke dhënë informacion në lidhje me mënyrën (provim final ose temë diplome), si dhe japin udhëzime (në rastin e provimit final) dhe literaturë shtesë (në rastin e temës së diplomës). Studentët deklaruan se po asistoheshin nga udhëheqësit e

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	temës. Dokumenti udhëzues përcakton se është udhëheqësi i diplomës që drejton, këshillon e konsulton.  <i>[Evidenca 82 -Rregullore e temes se Diplomes]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Ne Ciklin e Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” studentët me mesatare të ponderuar mbi 8 mund të pezgjedhin zhvillimin e temës së diplomës ndërsa studentët që nuk e arrijne këtë mesatare zhvillojnë një provim final. Provimi final teston konceptet themelore dhe njohuritë e marra gjatë 3 viteve akademike. Teza e provimit përbëhet nga pyetje me zhvillim e alternativa, nga lëndët profesionale kryesore dhe mbi bazën e peshës specifike që ka patur në programin e studimit. Studenti e mbron temën para komisionit.  <i>[Evidenca 82 -Rregullore e temes se Diplomes]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	Nga vizita në UMT në takimin me studentët dhe në takimin me stafin akademik të DIEE, të dy palët konfirmuan se studentët ndihmohen përmes orientimeve të vazhdueshme, informacioneve e literaturës në procesin e përmbylljes së studimeve. Dokumenti udhëzues përcakton se është udhëheqësi i diplomës që drejton, këshillon e konsulton. Studentët deklaruan se ishin orientuar për temat që duhet të zgjidhnin.  <i>[Evidenca 82 -Rregullore e temes se Diplomes] [Shenime ne vizite]</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni vë në dispozicion ambjentet e tij (laboratorët) ose lehtëson aksesin në ambjentet e institucioneve bashkëpunuese në mbështetje të realizimit praktik të punimit të diplomës.  <i>[Evidenca Nr. 30- Asetet Infrastrukturore, akademike UMT] [Evidenca Nr. 56- Lista e kompanive me te cilet institucioni ka marreveshje bashkepunimi]</i>
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Studentët në “Universitetit Metropolitan Tiranë”, mbështeten nga udhëheqësi i temës edhe në aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës. Udhëheqësi i temës bën një vlerësim të punimit i cili merret në konsideratë nga komisioni.  <i>[Evidenca 82 -Rregullore e temes se Diplomes] [Evidenca Nr.81-rregullore per udheheqjen e diplomave]</i>
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Punimi i diplomës vlerësohet me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Vlerësimet me notë janë nga 1 në 10, ku nota më e ulët për kalim është 5.  <i>[Evidenca Nr.81- rregullore per udheheqjen e diplomave]</i>
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Bazuar në procedurën e diplomimit studenti pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj të miratuar nga Senati Akademik i “Universitetit Metropolitan Tiranë”, ne përputhje me udhëzimet e Ministrisë se Arsimit dhe Sportit.  <i>[Evidenca Nr.81- rregullore per udheheqjen e diplomave] [Evidenca Nr.18, Modeli i diplomes] [Evidenca Supplement Diplome Bachelor]</i>
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Sipas RVB, në përfundim të studimeve, institucioni vendos në dispozicion të studentëve një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, sipas vitit akademik përkatës, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë.

<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Sipas RVB, Zyra e Arkivës mban një kopje të dokumentacionit të studentit për një periudhë të pacaktuar me qëllim pajisjen e studentëve me informacione nëse kërkohen.  [Evidenca Nr. 15, Rregullore e Sekretarise][Evidenca Nr. 35, Rregullore e Arkives] [Vizita në Institucion]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<input checked="" type="checkbox"/>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<input checked="" type="checkbox"/>


#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	UMT ka ngritur një strukturë , ku si pjesë e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse operojnë disa zyra ndër të cilat Zyra e Burimeve Njerëzore dhe zyra e Protokoll-Arkivës. Zyra e Burimeve Njerëzore ka në përgjegjësi mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave për personelin akademik ,ndihmës akademik dhe administrativ. Kjo strukturë vepron në nivel institucioni. Nga takimi me anëtarët e këtij sektori dhe verifikimi me zgjedhje i dokumentacionit që kjo drejtori ka në administrim, u vu re se dokumentacioni për stafin akademik të rekrutuar bëhet konform ligjit. Në dosjen individuale të personelit akademik, përveç dokumentacionit të dorëzuar në pranimin e tij në institucion, janë edhe kontratat e punës me afat 1 vjeçar për personelin pa gradën shkencore “Doktor”. Personeli akademik me gradën shkencore “Doktor” e sipër ka kontratë pa afat.  [Evidenca Nr.11 - Lista e dokumentacionit per rekrutimin e stafit akademik]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Nga verifikimi i procedurave të punësimit për personelin akademik në UMT, del e qartë se Zyra e Burimeve Njerëzore zbaton procedura që parashikohen në Rregulloren dhe Statutin e UMT dhe në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Procedura fillon me marrjen e kërkesës prej departamentit që ka vend vakant (kërkesa i drejtohet Rektorit të UMT),

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>shoqëruar me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përzgjedhjes dhe pranimit së kandidatit dhe grupin e lëndëve që ka interes DIEE. Vendi vakant shpallet në faqen web të UMT sëbashku me kriteret e përzgjedhjes së kandidatit. Më pas me konkuresit që kanë dorëzuar dosjen personale me dokumentacionin e kërkuar, zhvillohet një intervistë me komisionin e vlerësimit, i cili më pas merr vendimin. Nga ana e Zyrës së Burimeve Njerëzore bëhet njoftimi përfundimtar për rezultatin e konkursit tek kandidatët pjesëmarrës.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 85- Rregullorja e rekrutimit te stafit akademik]</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Aktet e brendshme rregullatore të UMT kanë të shprehura procedurat dhe kriteret e përgjithshme për rekrutimin e personelit akademik.</p> <p>Kriteret specifike të rekrutimit shprehen prej njësisë bazë në përputhje me nevojat që ka. Këto kriteret specifike i bëhen me dije Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe kjo e fundit i bën publike në njoftimin e bërë në faqen web të UMT.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 85- Rregullorja e rekrutimit te stafit akademik]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat e ndjekura nga strukturat e UMT për rekrutimin e personelit akademik vlerësojnë kandidatët e interesuar mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike, të cilat publikohen dhe synojnë të përzgjedhin personel akademik me kualifikimin e duhur dhe në përputhje me natyrën e përmbajtjen e programit të studimit. Nga ana e DIEE u shpreh shqetësimi se rekrutimi i personelit akademik me grada shkencore është shumë i vështirë edhe për shkak të mosfunksionimit të shkollave të doktoratës prej disa vitesh.</p> <p><i>[Evidenca Nr.11 - Lista e dokumentacionit per rekrutimin e stafit akademik]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<input checked="" type="checkbox"/>

<p><b>Standardi IV.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>UMT ka vendosur në dispozicion të FSHKIT godinën , në katin e parë të së cilës ndodhet edhe biblioteka me sipërfaqe totale (2 ambiente) 110 m<sup>2</sup>. Ambientet e tjera të godinës janë auditore, laboratore e zyra për stafin akademik e ndihmës akademik të fakultetit.</p> <p>Ambientet janë të mirëmbajtura, me dritë, dhe të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillimin e mësimi. FSHKIT ka në dispozicion 16 zyra për stafin akademik e stafin ndihmës akademik, 27 nyja sanitare për</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>studentët e stafin, ambiente të përbashkëta, 20 ambiente për auditore e klasa mësimi, 3 salla për aktivitete promovuese, 4 laboratore për studentët e FSHKIT, 2 klasa laboratore informatike, etj.</p> <p>Numri i klasave për zhvillimin e mësimi jepet në total për të gjithë FSHKIT, dhe shpërndarja bëhet sipas numrit të studentëve. Nga stafi u pranua që ambientet janë të mjaftueshme edhe për personelin akademik edhe për studentët duke patur parasysh prurjet e deritanishme.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 30- Asetet Infrastrukturore, akademike UMT</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>UMT ka hartuar dy strategji për zhvillimin e ndërkombëtarizimin, me qëllim kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik dhe shkëmbim eksperiencash në mësimdhënie. Në rang institucioni, ka një listë me 21 subjekte IAL brenda e jashtë vendit, për bashkëpunime e mobilitete të stafit e studentëve, por nuk ka specifikime në lidhje me përfitimet që ka patur DIEE nga këto marrëveshje. Nga vizita në institucion, në takimin me Përgjegjësën e Departamentit u konfirmua se nga PS Bachelor në Inxhinieri Elektrike nuk ka patur mobilitet as nga studentët as nga stafi, ndërsa për studentët e PS-ve të tjera të FSHKIT, ka patur 5 mobilitete studentësh. Nga ana tjetër UMT mbështet finaciarisht shpenzimet e stafit akademik për pjesëmarrjen e tyre në konferenca.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 57-Lista e marreveshjeve Erasmus+][ Evidenca 66 Lista e shkëmbimeve ne kuader te Erasmus+]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>UV bën përpjekje që të zbatojë metoda të reja bashkëkohore të mësimdhënies, në përshtatje me programin e studimit dhe në ndihmesë të rritjes së cilësisë. Sipas grupit të vlerësimit të brendshëm, është hartuar nga institucioni edhe një udhëzues për zhvillimin e mësimdhënies me metoda të reja dhe në përshtatje me fushat e studimit. Në mbështetje të këtyre metodave, UMT ka ofruar logjistikën e nevojshme duke plotësuar klasat me vidioprojektorë, disa klasa janë me kompjutera etj. Klasat e auditorët janë të pajisura me materialet e nevojshme për zhvillimin e kombinuar të mësimi në mënyrë tradicionale dhe bashkëkohore.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 43, Udhezues per planin e mobilitetit per stafin akademik ne kuader te Erasmus+][Evidenca Nr. 57-Lista e marreveshjeve Erasmus+][ Evidenca 66 Lista e shkëmbimeve ne kuader te Erasmus+]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>UMT ka staf akademik e ndihmës akademik angazhohen jo vetëm në zhvillimin e mësimi por edhe në kërkim shkencor dhe në mbështetjen e studentëve për zgjidhjen e problemeve të tyre gjatë viteve të studimit në ciklin e parë. Nga ana e DIEE janë marrë në punë personel akademik në përputhje me fushën e studimit dhe kërkimit shkencor të vlefshëm për programin e studimit. Vështirësia për ta qëndron në rekrutimin e stafit me kualifikime më të larta shkencore.</p> <p>Gjithsesi UMT nxit stafin aktual dhe e mbështet në rritjen e tyre akademike. Ngarkesa mësimore e tyre është në përputhje me normativat në fuqi. Do të parapëlqejë zhvillimi i një numri më të vogël lëndësh për disa prej pedagogëve, të cilët zhvillojnë mbi 4 deri në 6 lëndë</p>

	semestrare, por kuptohet vështirësia, pasi numri i studentëve në këtë program studimi nuk është i lartë.			
	[Evidenca Nr.25- Ngarkesa mesimore per programin e studimit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			☒	

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UMT ka vënë në dispozicion të FSHKIT godinën që përdoret për zhvillimin e mësimi (klasa, auditore), ambiente të përbashkëta (koridore, biblioteka, nyje sanitare), ambiente zyra për stafin etj. Në godinën tjetër pranë saj gjenden ambientet e laboratoreve. Sipas tabelës përmbledhëse ofruar nga UMT, godinat ku zhvillohet mësimi për FSHKIT ka sipërfaqe totale 2250m<sup>2</sup> dhe ka një numër total prej 169 studentësh që zhvillojnë mësimin në këtë godinë, për të gjitha programet e studimit që mbulohen nga FSHKIT. Si rrjedhim, koeficienti i përdorimit të ambienteve të FSHTN prej studentëve të tij është <math>2250/169 = 13.3 \text{ m}^2/\text{student}</math>. Bazuar në VKM 418 datë 10/05/2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• IAL me drejtim Shkencat e Natyrës ky koeficient është 2.5</li> <li>• IAL me drejtim Inxhinieri e Teknologji, ky koeficient është 5.</li> </ul> <p>Pra mund të themi se kapacitetet e ambienteve të shfrytëzueshme për studentët nuk janë shfrytëzuar plotësisht, madje janë me reserve duke mundësuar rritje të numrit të studentëve.</p> <p>Ambientet e FSHKIT nuk kanë mungesë sigurimin e ajrit të kondicionuar dhe ngrohjes qëndrore, pra kushte normale për zhvillimin e mësimi në periudhën e verës dhe dimrit.</p> <p>[Evidenca Nr. 30- Asetet Infrastrukturore, akademike UMT]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset e klasave, auditorëve, laboratorëve etj, ku zhvillohet mësimi, janë të pajisura me kompjutera, videoprojektorë, tabela interaktive e internet. Përgjithësisht mësimi zhvillohet i kombinuar: sipas mënyrës tradicionale dhe metodave që përdorin teknologjinë bashkëkohore për rritjen e efektivitetit të mësimdhënies e mësimnxënies. Kjo metodologji mundësohet sepse klasat janë të pajisura mirë me infrastrukturën për këtë tipologji mësimdhënies. Në klasat e leksioneve, seminareve, në laboratore e në bibliotekë, ambientet janë</p>

	<p>të pajisura me mjete didaktike e pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 30- Asetet Infrastrukturore, akademike UMT]</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>DIEE ka në dispozicion të studentëve që studiojnë në programin “Bachelor në Inxhinieri elektrike” 4 laboratore me disa module, ku zhvillohen seancat laboratorike për lëndët: Elektroteknikë, Matje elektrike, Elektronikë analoge dhe Elektronikë fuqie, Elektronikë analoge e digjitale, makina elektrike, teori sinjalesh etj. Nga takimi me përgjegjës të departamentit u konfirmua se UMT dhe FSHKIT vazhdon të ketë në vëmendje mundësinë e ngritjes së laboratoreve të reja për lëndë të karakterit profesional, duke e konsideruar këtë aspekt si një ndër pikat e forta të saj .</p> <p><i>[Evidenca Nr. 30- Asetet Infrastrukturore, akademike UMT]</i> <i>[Evidenca 70 - Lista e laboratoreve ne funksion te programit te studimit]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>FSHKIT ka 2 laboratore informatike me rreth 15 kompjutera secili, që i shërben studentëve të gjithë programeve të studimit që mbulon fakulteti. Kompjuterat e laboratorëve janë të pajisur me softet inxhinierike specifike dhe të vlefshme për mbështetjen e procesit mësimor, sipas nevojave të programit të studimit.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 30- Asetet Infrastrukturore, akademike UMT],</i> <i>[Evidenca 70 - Lista e laboratoreve ne funksion te programit te studimit]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Nga UMT ka përpjekje që të krijojë mundësi bashkëpunimi me institucione e subjekte shtetërore e private me qëllim zhvillimin e praktikave mësimore e profesionale. Në dosjen e akreditimit ka një listë me institucione shtetërore e subjekte nga biznesi që operojnë në fushën e inxhinierisë elektrike , ku kryejnë praktikën mësimore sipas kontratave respektive, konform rregullave në fuqi, studentët e Inxhinierisë Elektrike. Në praktikën e tyre tentohet që kontratat e bashkëpunimeve të rriten me bashkëpunime të reja, me qëllim që mjediset e praktikave mësimore të jenë të janë sa më profesionale e të mjaftueshme njëkohësisht.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 17- Rregullore FSHKIT]</i> <i>[Evidenca Nr. 63 - Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te studimit]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			☒	

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UMT ka në ambientet saj të Godinës 1, bibliotekën mësimore me 10 vende, e cila është në dispozicion të studentëve të FSHKIT, për studentët e ciklit bachelor dhe master. Biblioteka funksionon me orar të përshtatshëm për shfrytëzimin prej studentëve, me 2 turne, dhe me orar të afishuar në hyrje të saj dhe të njoftuar në faqen web.</p> <p>Sipas punonjësës të bibliotekës dhe studentëve, ambientet e bibliotekave kanë kapacitet të mjaftueshëm . Biblioteka ka kushte të mira, pajisur me literature, kompjutera dhe me orar të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për studentët.</p> <p><i>[Evidenca Nr.30 Asetet Infrastrukturore, akademike UMT]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ka kryesisht tekste mësimore dhe literature ndihmëse në gjuhë shqip (21 tituj) dhe të huaj : anglisht 48 tituj, italisht 1 titull, por ato konsiderohen të pamjaftueshme për studentët e programit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike”. Fondi i saj nevojitet të pasurohet me tituj të rinj dhe revista teknike bashkëkohore, me qëllim mbështetjen e studentëve në punën kërkimore për detyrat e kursit në lëndët e formimit profesional dhe diplomat. Literatura e vlefshme për studentët e inxhinierisë elektrike në bibliotekë është relativisht e ulët me gjithë përpjekjet që UMT bën për mirëmbajtjen e tyre.</p> <p>Në bibliotekën e FSHKIT ka gjithsej rreth 70 tituj, por titujt në dispozicion të studentëve të inxhinierisë elektrike nuk specifikohen dhe konsiderohet i pamjaftueshëm. Literaturata në gjuhën shqip është kryesisht tekst mësimor.</p> <p><i>[Evidenca Nr.30, Asetet Infrastrukturore, akademike UMT]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga ana e UMT është krijuar mundësia për të gjithë studentët e programeve të studimit, që të shfrytëzojnë bibliotekën on-line në ambientet e bibliotekës së UMT, me akses të barabartë, pa pagesë. Në faqen zyrtare të UMT jepen edhe informacionet e nevojshme së bashku me manuallet e përdorimit për studentët dhe pedagogët.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion si dhe nga materialet në dosjen e akreditimit, u konstatua se në bibliotekën ku marrin shërbim studentët e programit të studimit “Bachelor në inxhinieri Elektrike”, ka një numër kompjuterash në sallën e leximit me softje kompjuterike të përshtatshme për shfrytëzimin e literaturës së huaj. Nga ana e UMT duhen bërë përpjekje për digjitalizimin e materialeve të bibliotekës.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në bibliotekë ka patur pasurime të vazhdueshme me tituj të rinj në gjuhën shqip dhe në gjuhë të huaj, por në dosjen e akreditimit ose RVB nuk jepen më shumë detaje në lidhje me përpjekjet që bëhen nga FSHKIT për rritjen e titujve të botimeve bashkëkohore në fushën e inxhinierisë elektrike, të cilat konsiderohen relativisht të ulëta. Për vitet akademike në vazhdim duhet që DIEE t’i kushtojë vëmendje shtimit të</p>



	<p>literaturës së huaj, botime të viteve të fundit, me qëllim që studentët e inxhinierisë elektrike të marrin dije sa më të përditësuara.</p> <p>[Ref. Vizita ne IAL]</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e UMT funksionon me orare të përshtatshme për përdorimin e tyre prej studentëve të dy cikleve, me 2 turne , nga e hëna në të premte, nga ora 8.00-21.00. Shfrytëzimi i ambienteve të tyre prej studentëve është në nivel të përballueshëm për kapacitetet ekzistuese dhe masën e interesit që studentët paraqesin për shfrytëzimin e saj.</p> <p>[Ref. Vizita ne IAL]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<input checked="" type="checkbox"/>	

<p><b>Standardi IV.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UMT në mbështetje të ligjit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015, mban në formë të shkruar 3 regjistra:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Regjistrin themeltar të studentëve</li> <li>2) Regjistrin e arritjeve akademike</li> <li>3) Regjistrin e diplomimeve dhe çertifikatave të lëshuara prej UV.</li> </ol> <p>Prej sekretarisë mësimore administrohen edhe:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. dosjet e regjistrimit të studentëve me dokumentacionin sipas kërkesave të MASR,</li> <li>b. dosjet me procesverbalet e vlerësimeve të studentëve sipas viteve akademike</li> <li>c. dosjet e transferimeve të studimeve dhe ç’regjistrimeve.</li> </ol> <p>Krahas kësaj, UMT ka në shfrytëzim platformën elektronike “edu4school” i cili u ofron përdoruesve (student e pedagogë) marrje informacionesh si : orari, rezultate provimesh, njoftime etj. Kjo platformë aksesohet me username e password nga secili anëtar i UMT. Platforma “gotomeeting” ofron disa shërbime si: e-learning (marrje materialesh prej pedagogëve), zhvillim mësimi online, dorëzime detyrash , komunikim interaktiv student-pedagog përmes hapësirës së dedikuar që ka secili student në këtë platformë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ</p>	<p>Nga sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohen informacionet dhe dokumentacioni përkatës që ka lidhje me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe për partnerët. Ky informacion administrohet prej drejtorive të UMT, duke filluar prej rekrutimit të tyre, e në vazhdimësi, në ndjekje të progresit akademik të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>tyre. Për këtë angazhohen Zyra e Burimeve Njerëzore, Sekretaria mësimore dhe Departamentet/dekanati. Ky dokumentacion ruhet në hardcopy dhe elektronikisht për të gjithë kategoritë e lartpërmendura dhe përditësohet sa here ka ndryshime gradash /titujsh ose pozicioni.</p> <p><i>[Evidenca Nr.02- Rregullore e Brendshme e UMT]</i></p>			
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<p>Sistemi i menaxhimit nuk siguron akses të dedikuar për informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët (marrje të tyre në formë automatike), por strukturat e ndryshme si : zyra e financës, sekretaria mësimore, zyra e burimeve njerëzore, departamentet etj, hartojnë informacione në formë tabelore ose shkresore dhe i ngarkojnë ato në platformë që të jenë të aksesueshme për përdoruesit e interesuar.</p> <p><i>[Evidenca Statuti i UMT]; [Evidenca Nr.02- Rregullore e Brendshme e UMT]; [Evidenca Nr.35, Rregullore e arkives]</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	<p>Sistemi i menaxhimit është me karakter modular dhe ka të integruar platformën “gotomeeting” që mundëson e-learning dhe komunikim interaktiv të studentëve e pedagogëve, për shkëmbim materialesh mësimore në format pdf, si dhe dorëzimin e detyrave të studentëve. Në faqen web të UMT gjendet edhe manuali i përdorimit të kësaj platforme.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 20 - Udhezues per perdorimin e struktures se teknologjise se informacionit]</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	<p>Ky sistem menaxhimi krijon mundësinë që personeli akademik e administrativ të monitorohen prej departamenteve në kohë reale dhe veç kësaj lejon marrjen e dhënien e raportimeve individuale ose mbi bazë njësie bazë për organet drejtuese e titullarët e tyre.</p>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<p>Në faqen zyrtare web të UMT: <a href="https://umt.edu.al">https://umt.edu.al</a>, jepet informacion për programet e studimit që ofrohen, në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në këtë faqe ka informacion për fakultetet/programet e studimit, për projektet ku bën pjesë UMT, legjislacioni: rregulloret, statuti etj, biblioteka on-line, studentët, kërkimi shkencor e publikimet e stafit akademik etj.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<input checked="" type="checkbox"/>

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Në dosjen e akreditimit është depozituar dokument që nuk përbën një raport financiar, në lidhje me të ardhurat që UMT ka mundur të mbledhë në 3 vite, 2017, 2018, 2019 për realizimin e misionit të saj. Këto ardhura janë realizuar prej :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) të ardhurat nga tarifat e regjistrimit, shkollimit</li> <li>2) të ardhurat prej granteve për kërkim e kontrata.</li> </ol> <p>Nga shifrat në raport duket qartë se burimi i të ardhurave është kryesisht tarifa e shkollimit, ndërsa të ardhurat prej granteve për kërkim zënë 1.8-3% të të ardhurave totale. Në raportin vjetor të NJSBC deklarohen shpenzimet që UMT bën për realizimin e objektivave të saj:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shpenzimet për paga, sigurime shoqërore 63%</li> <li>• shpenzime për qera, energji elektrike, ujë, shpenzime mirëmbajtjeje, shpenzime për materiale kancelarie, blerje librash etj. 27%</li> <li>• shpenzimet për Qendrën Kërkimore dhe Qendrën e Inovacionit, për pajisje laboratorike dhe trajnime të stafit akademik 10%</li> </ul> <p>Mbi bazën e këtyre shpenzimeve janë llogaritur edhe tarifat e shkollimit për të gjitha programet dhe nivelet e studimit.</p> <p><i>[Evidenca 55 - Raporti vjetor i aktivitetit mesimor, kërkimor dhe financiar]; [Evidenca Nr.40, Shpenzime dhe te ardhura ne 3 vitet e fundit]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Raporti financiar mbi të ardhurat dhe shpenzimet që UMT kryen për realizimin e misionit si IAL, është paraqitur si informacion në rang institucioni por jo në rang fakulteti. Nuk ka një plan financimi të argumentuar të programit të studimit në rang fakulteti në lidhje me financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet etj. Në formë tabelore paraqiten të ardhurat për vitet: 2017, 2018, 2019 (jo i plotë), mungon viti 2020. Të ardhurat nga tarifat e shkollimit zënë peshën kryesore, 97-98% të ardhurave totale.</p> <p>Këto të ardhura përdoren prej UMT në financimin e :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) paga e sigurime shoqërore për burimet njerëzore, bursa studentësh,</li> <li>2) mbështetje e kërkimit shkencor,</li> <li>3) organizime konferencash,</li> <li>4) shpenzime operative :për qera, fatura energjie e uji,</li> </ol> <p>blerje librash e material didaktike për laboratore etj.</p>

	[Evidenca Nr.40 - Shpenzime dhe te ardhura ne 3 vitet e fundit] [Evidenca Nr.41 - Buxheti i UMT: procedura e hartimit dhe miratimit per 2019 ]			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Sipas Zyrës së Financës , Raporti financiar është bërë çdo vit, auditohet nga ekspert i jashtëm dhe pasqyron burimet financiare të UMT. Gjithashtu detajohet sipas viteve edhe përdorimi i financimeve për paga, bursa, shpenzime operative, shpenzime për mbështetjen e stafit akademik në pjesëmarrje konferencash etj.  Raporti mbahet në nivel institucioni, me të dhëna të pandara sipas fakulteteve. Për një vlerësim më real të kostove të programeve të studimit, del e nevojshme që kontabiliteti të mbahet mbi bazë njësie kryesore ose njësie bazë. Kjo do të bënte një orientim më efektiv drejt programeve të studimit që kërkon tregu i punës ose kanë prioritet kombëtar ose lokal dhe mbylljen e programeve të studimit që nuk justifikojnë shpenzimet.  [Evidenca Nr.42- Evidence Auditimi Financiar]			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Raportet financiare janë hartuar në fund të çdo viti kalendarik. Në dosjen e akreditimit nuk janë paraqitur raportet financiare për 3 vitet e fundit,por vetëm për vitin kalendarik 2018. Ky raport paraqet në tabela të dhëna krahasimore në lidhje me planifikimin dhe faktin e shpenzimeve për çdo zë. Diversifikime të mundshme të financimeve janë bërë me qëllim garantimin e ecurisë së programeve të studimit dhe mbarëvajtjen e tyre.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Në rang institucioni, UMT dëshmon përmes raportit financiar , se përveç tarifave të shkollimit ka edhe burime të brendshme financimi, që emërtohen si “të ardhura nga grantet për kërkim dhe kontrata” por që nuk specifikohet më tej. Këto të ardhura janë të vogla krahasuar me totalin e të ardhurave nga institucioni, maksimumi rreth 3%. Kështu që UMT duhet të bëjë përpjekje për rritjen e kapaciteteve të vetëfinancimit me qëllim përmirësimin e situatës financiare dhe të mundësojë gjenerim të ardhurash për rritjen e cilësisë dhe standardeve në programet e studimit që ofron si dhe garanton zhvillimin e qëndrueshëm të IAL.  [Evidenca Nr.40- Shpenzime dhe te ardhura ne 3 vitet e fundit]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<input checked="" type="checkbox"/>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<input checked="" type="checkbox"/>	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UMT zbaton politika bazuar në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet rregullatore në fuqi. Mbështetur në statutin dhe rregulloret e brendshme të të gjitha niveleve të UMT, ka hartuar procedura që ndjekin zhvillimin e formimit akademik të studentëve sipas fushave të programeve të studimit nga fillimi i studimeve e deri në diplomimin e tyre. Procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi detajohen në rregulloren e programit të studimit si: nota mesatare, grupet sociale që përfitojnë bursa, kuota etj. Gjithashtu specifikohet dokumentacioni i nevojshëm dhe mënyra e regjistrimit, marrja e informacioneve të nevojshme në lidhje me tarifën e shkollimit, materialet që UMT i ofron çdo studenti për të lehtësuar zhvillimin e studimeve, si psh laptop me softet e nevojshme të instaluar, guidën e studentit etj.</p> <p><i>[Evidenca Nr.01-Statuti i UMT]; [Evidenca Nr.02, Rregullore e Brendshme UMT]; [Evidenca Nr. 17- Rregullorja e FSHKIT]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Përmes transparencës së informacionit, politikat dhe procedurat e zbatuara në procesin e formimit akademik të studentëve mundësojnë të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student në hyrje dhe për gjithë studentët në rrugëtimin e tyre drejt diplomimit. Pranimi i studentëve në UMT bëhet pas publikimit të listave me renditjen e studentëve në 3 faza. Më pas përveç informacionit që jepet në faqen zyrtare të UMT, çdo student ka mundësi që përmes adresës zyrtare të tij/saj të aksesojë sistemin “Edu4school” dhe të përfitojë informacione shtesë sipas nevojave.</p> <p><i>[Evidenca Nr.01-Statuti i UMT]; [Evidenca Nr.02, Rregullore e Brendshme UMT]; [Evidenca Nr. 17- Rregullorja e FSHKIT]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga ana e UMT shpallja e kriterëve dhe procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve në programet e studimit janë të kuptueshme dhe të aksesueshme në mënyra të ndryshme: faqja zyrtare web e UMT, statuti i UMT, Rregullorja, njoftimet. Gjithashtu informacioni mund të gjendet i shpallur edhe në ambientet e brendshme të fakulteteve të UMT në këndet e informacionit etj. Edhe procedurat e transferimit të studimeve, ekui valentimeve e njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme kryhet përmes komisionit ad-hoc që DIEE ngre në fillim të çdo viti akademik për këto qëllime. Studentët mund të marrin informacion edhe në zyrën e sekretarisë mësimore dhe zyrën e studentit.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 01 - Statuti i UMT]; [Evidenca Nr. 02, Rregullore e Brendshme UMT]; [Evidenca Nr.29- Guida e studentit]</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Bazuar në propozimet që bëjnë departamentet, Senati Akdemik i UMT miraton me kriteret e veçanta për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe i bën ato publike përmes formave të ndryshme të njoftimit. Në hartimin e kritereve për përzgjedhjen dhe pranimin e kandidatëve, departamenti bazohet në udhëzimet e MASR dhe Maturën Shtetërore.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Senati Akdemik i UMT miraton propozimet dhe kuotat e DIEE në lidhje me kriteret e përzgjedhjes dhe pranimit në programin e studimit "Bachelor në Inxhinieri Elektrike". Këto propozime bazohen tek Udhëzimet e MASR në lidhje me kriterin e notës mesatare për ciklin e parë të studimeve si dhe në kapacitetet e FSHKIT në lidhje me kuotat. Kuotat parashikojnë pranime nga vendi, trojet shqiptare, nga jashtë vendit, komunitetet e pakicat si dhe personat me aftësi të kufizuara, statusi jetim. Parashikohen edhe kuota për transferim studimesh dhe program të dytë studimi.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara se të fillojë periudha e plotësimit të formularëve të aplikimit prej maturantëve, Stafi i UMT merr pjesë në aktivitete promovuese në rrethe ku përfaqësuesit e departamenteve japin informacion në lidhje me ofertën didaktike e formuese të programeve të studimit. Në këto takime marrin pjesë edhe studentë aktualë që ndajnë përvojën e tyre. Si mjete promovuese përdoren edhe rrjetet sociale e televizionet lokale.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<input checked="" type="checkbox"/>


<p><b>Standardi V.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Studentët e marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik në mënyra të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Duke konsultuar në faqen zyrtare web të UMT dokumenta si Statuti, Kodi i Etikës, rregulloret e programit të studimit etj.</li> <li>• Në takimet e para me pedagogët e lëndëve, ata njihen me programin e lëndës, detyrimet që duhet të përmbushin për futjen në provim,</li> <li>• Mënyrat e vlerësimit, riprovimeve, kalimi në vitin pasardhës, transferimin e studimeve etj</li> <li>• Procedurën e diplomimit etj.</li> </ul> <p>Duke u konsultuar me zyrën e studentit, sekretarinë mësimore etj.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Përmes dokumentave bazë si Statuti i UMT, dhe Rregulloret e PS që aksesohen online, studentët marrin informacion të mjaftueshëm për procedurat e njohjes së studimeve të mëparshme ose transferimit të studimeve. Për informacion më të detajuar, studenti drejtohet edhe në zyrën e studentit, sekretarinë mësimore ose departamentin përkatës. Departamenti ngre komisionin ad-hoc dhe kryen procedurën e ekuivalentimit të krediteve për njohjen e studimeve të mëparshme, transferimit të studimeve ose në rastin kur studentët kanë kryer mobilitete përmes programeve e marrveshjeve që UMT ka me universitetet jashtë ose brenda vendit. Nga tabela 21 e aneksit informativ, shihet se DIEE ka kryer regjistrimin e studentëve përmes procedurës së transferimit të studimeve :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për vitin akademik 2019-2020 transferuar 4 studentë</li> <li>• Për vitin akademik 2020-2021 transferuar 3 studentë.</li> </ul> <p><i>[Evidenca Nr. 44 - Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit ne programet e UMT]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të fituara prej tyre gjatë zhvillimit të programit të studimit. Ky informacion merret në mënyra të ndryshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Nga rregullorja e DIEE dhe rregullorja e programit të studimit, që aksesohen në faqen zyrtare web të UMT.</li> <li>2) Nga pedagogu i lëndës</li> <li>3) Nga sekretaria mësimore.</li> </ol> <p>Këto informacione janë në përputhje me specifikimet e bëra në syllabuset e lëndëve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kritere dhe procedura janë përcaktuar qartë edhe për punimin e diplomës dhe provimin e formimit. Këtë informacion studenti e merr nga rregullorja e DIEE, rregullorja e diplomimit dhe rregullorja e programit të studimit. Studenti diplomohet me punimin e një teme diplome, nëse student ka fituar të gjitha kreditet prej lëndëve të programit të studimit dhe praktikës. Punimi i Diplomës ka 30 kredite dhe duhet të plotësojë kushtet që specifikohen në rregulloren e PS.</p> <p>Informacioni merret edhe në sekretarinë mësimore, zyrën e mbështetjes së studentit ose DIEE.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 04, Rregullore e Programit te Studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>UMT në mënyrë periodike para plotësimit të formularit të aplikimit prej maturantëve, organizon takime promovuese duke ftuar në ambientet e saj studentë të mundshëm në të ardhmen. Gjithashtu organizon aktivitete e takime të hapura, ditët e informimit të maturantëve si dhe përgatit udhëzues, fletëpalosje në ndihmë të informacionit për maturantët. Në këto aktivitete angazhohen anëtarët e departamenteve, anëtarë të zyrës së Karrierës e Alumni etj.</p>




Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informacionin për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, çdo student në UMT e merr në faqen zyrtare web të universitetit, e merr në takimin e parë informues në fillim të studimeve, por mund ta marrë edhe prej pjesës së stafit të dedikuar punës me studentin në nivel UMT ose FSHKIT.  <i>[Evidenca Nr 01- Statuti UMT; [Evidenca Nr 23-Plani i Mesimor; [Evidenca NrNr. 61 Te dhena te pergjithshme mbi programin e studimit</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nga takimi me studentët doli e qartë se informacioni që ata kanë nevojë të marrin në lidhje lëndët, modulet, përbajtjen dhe veprimtaritë formuese merren gradualisht prej pedagogëve të lëndës por edhe në mënyrë të plotë mund të merren prej informacionit në zyrën e studentit, nga platform “Edu4school” ose në faqen zyrtare.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	UMT organizon çdo vit Panairin e Karrierës, ku studentët dhe përfaqësues nga biznesi lokal mund të takohen për të identifikuar ofertën që ka tregu aktual i punës. Gjithashtu edhe pedagogët e programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike” me njohjet dhe rekomandimet e tyre shërbejnë si një urë lidhëse midis bizneseve apo subjekteve shtetërore që zhvillojnë aktivitetin në fushën e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike apo me subjekte që zhvillojnë aktivitet në fushën e industrisë.  <i>[Evidenca Nr. 46- Rregullore mbi funksionimin e Zyres se Karrieres UMT]; [Evidenca Nr. 56- Lista e kompanive me te cilet institucioni ka marreveshje bashkëpunimi] [Evidenca Nr.83-Rregullore e Praktikave mesimore]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	UMT me anë të sistemit të menaxhimit dhe informimit, në kanalin “studentët” gjejnë informacionin e përditësuar për të cilin ata kanë nevojë në lidhje me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën etj. Nga ana tjetër prej faqes zyrtare web apo edhe në stendat informuese merret informacioni për infrastrukturën dhe shërbimet e UMT në lidhje dhe në funksion të procesit mësimor. Java e parë i dedikohet orientimit të studentëve për programin e studimit, që e

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	kombinuar me guidën e studentit, plotësojnë më së miri të drejtën dhe kërkesat e studentëve për informacion në UMT.			
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Sistemi i menaxhimit të brendshëm përmes “Edu4school”, që jep informacione të përditësuara në lidhje me procesin mësimor të gjithë programeve të studimit, është i aksesueshëm prej studentëve nëpërmjet llogarisë personale të tyre të krijuar prej UMT dhe që është aktive që në fillim të studimeve dhe për sa kohë gëzon statusin student. Duke qenë se është një sistem që mund të aksesohet on-line dhe në distancë, bëhet lehtësisht i aksesueshëm dhe shumë i dobishëm për studentët e gjithë programeve të studimit. Aktiviteti mësimor në kushtet e pandemisë u mundësua përmes platformës “Gotomeeting”, ku studentët zhvilluan mësimin online, aksesuan materialet didaktike dhe komunikimin interaktiv me pedagogët.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				☒

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Nga materiali i paraqitur prej UMT në dosjen e akreditimit, është e qartë se institucioni mban statistika vjetore (mbi bazë vitesh akademike) në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, të ç’regjistruar, raportin përkatës meshkuj/femra në çdo program studimi, moshën e studentëve. Këto të dhëna statistikore prodhohen prej sekretarisë mësimore dhe përmes raporteve vjetore të NjSBC raportohen në MASR dhe disponohen edhe nga fakultetet dhe departamenteve.  <i>[Evidenca Nr. 50 - Raporti MASR mbi verifikimin e kuotave të pranimit në UMT, viti akademik 2019-2020]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Tabelat e përpiluara nga Sekretaria Mësimore kanë informacion statistikor të detajuar, mbi bazë vitesh akademike, në lidhje me studentët:  <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të regjistruar në çdo program studimi</li> <li>• Të diplomuar në çdo program studimi</li> <li>• Të tërhequr ose të larguar para përfundimit të programit të studimit , ç’regjistruar etj , në çdo program studimi</li> </ul> Në dosjen e akreditimit ka të dhëna për prurjet e reja në Bachelor në Inxhinieri Elektrike. Nga të dhënat duket se në këto vite është në rritje

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>si nota mesatare e studentëve të regjistruar në këtë program studimi ashtu dhe numri i studentëve. Por mbetet evidente nevoja e rritjes së përpjekjeve prej DIEE që për programin e studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektrike” të tërhiqen në vazhdimësi studentë me notë mesatare në rritje me qëllim që cilësia e produktit në dalje të jetë në nivelin e kërkesave të tregut të punës. Gjithashtu, vihet re se numri i studentëve është ende i ulët, për pasojë janë aktive vetëm 2 programe studime nga 5 potencialë që ka UMT në Bachelor në Inxhinieri Elektrike dhe Elektronike.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaria mësimore e UMT disponon të dhënat në lidhje me ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit, ecuri e cila reflektohet në 3 regjistra:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Regjistri themeltar, ku secili student i regjistruar ka të dhënat personale si dhe numrin e matrikullimit të dhënë prej MASR.</li> <li>2) Regjistrin e arritjeve akademike, ku për secilin student pasqyrohen vlerësimet me notë për secilën lëndë të programit mësimor</li> <li>3) Regjistrin e të diplomuarve.</li> </ol> <p>Këto të dhëna ruhen edhe në format elektronik përveç se fizik.</p> <p>Për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri elektrike që po vlerësojmë nuk ka ende asnjë student të diplomuar.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit realizohet përmes platformës “Edu4school” dhe mundëson aksesimin dhe verifikimin e informacionit për studentët dhe ecurinë e tyre në programin e studimit në mënyrë të lehtë por të sigurtë, duke u mbështetur në parimin e konfidencialitetit dhe ruajtjes së të dhënave personale. Ky informacion mund të merret në kohë reale prej studentëve në sistem ose në formë të printuar pranë sekretarisë mësimore, personalisht ose përmes personave të autorizuar, konform akteve ligjore në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Nga materialet në dosjen e akreditimit, del e qartë se analizat vjetore në nivel departamenti apo institucioni trajtohet midis të tjerave dhe profili i studentëve të regjistruar si dhe cilësia e tyre në hyrje dhe dalje të programit të studimit. Nga ana e DIEE bëhen përpjekje për rritjen e cilësisë së studentëve në hyrje përmes promovimit të UMT në gjimnazet e disa qarqeve, por ende kërkohet shumë punë për arritjen e qëllimit në këtë aspekt. Bazuar në të dhënat e dosjes së akreditimit (anekset) nota mesatare e studentëve në hyrje për :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• viti akademik 2020-2021 nota mesatare është 8.04</li> <li>• viti akademik 2019-2020 nota mesatare është 7.18</li> <li>• viti akademik 2018-2019 nota mesatare është 6.9.</li> </ul> <p>Gjithashtu trajtohet edhe cilësia e studentëve në përfundim të programit të studimit që reflektohet tek cilësia e punësimit të tyre. Nga takimi me specialistët e zyrës së Karrierës dhe Alumni, u pranua që</p>




	bëhet përpjekje për mbajtje informacioni për studentët e diplomuar pas punësimit të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			☒	

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Në zbatim ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të e RSH” dhe në mbështetje të Statutit të UMT, studentët kanë të drejtë të jenë pjesë e vendimarrjes në të gjitha nivelet. Ata kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik , NJSBC, komisionet e vlerësimit të brendshëm, zgjedhur përmes një procesi zgjedhor në rang institucioni. Nga ana tjetër Këshillat Studentore janë krijuar mbi bazë njësie kryesore dhe nga ana e UMT tentohet që studentët të bëhen pjesë e gjithë komisioneve.  <i>[Evidenca Nr. 78- Anetaret e Njesise se Sigurimit te Brendshem te Cilesise]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga takimi me stafin akademik dhe studentët si dhe bazuar në dokumentacionin e dosjes së akreditimit, mund të konfirmojmë se në UMT studentët përfshihen në vendimmarrje përmes përfaqësuesve të zgjedhur prej tyre në nivele të ndryshme të institucionit (Senat Akademik, NJSBC, komisione të vlerësimeve të brendshme në nivel departamenti e fakulteti etj, ku diskutohen çështje të rëndësishme si: Buxheti i UMT, adresimi i kërkesave të studentëve etj.). Studentët gjithashtu marrin pjesë sistematikisht në vlerësimin e procesit akademik, në pyetësorin për procesin akademik që zhvillohet 2 herë në vit, nëpërmjet shprehjes së mendimeve të tyre dhe këshillimit e sugjerimit për përmirësimin e punës. DIEE merr parasysh vërejtjet dhe komentet e dhëna në pyetësor duke i bërë pjesë të diskutimit në departament me qëllim që rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Ky proces e bën vendimarrjen e studentëve jo vetëm të matshëm por edhe të frutshëm.  <i>[Evidenca Nr.01 -Statuti UMT]; [Evidenca Nr. 32 - Aktet per përfshirjen e studenteve ne organet kolegjiale te UMT]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin	Në UMT, procedurat e përparimit të studentëve përgjatë zhvillimit të programit të studimit apo ato të njohjes së studimeve të pjesshme ose të plota, bazohen në aktet rregullatore të brendshme dhe zbatohen konform kornizës logjore në fuqi. Nga ana e DIEE bëhet përpjekje

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>që procedurat të mos jenë burokratike por të ndihmojnë integrimin e studentëve në programet e studimit thjesht dhe me transparencë. Kjo arrihet nëpërmjet përfshirjes së studentëve në komisionet ad-hoc që departamentet krijojnë në këtë proces. Nga ana tjetër ngarkesa akademike e studentëve të inxhinierisë elektrike synohet të alternohet dhe balancohet midis leksioneve, seminareve e praktikës. Maksimumi i ngarkesës mësimore në auditor është 22 orë/javë (1845/6/14).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Pyetësori i çdo fundsemestri që UMT organizon, dhe marrja parasysh e mendimit të tyre në planin e masave, garanton që pjesëmarrja e studentëve në rishikimin e programeve të studimit të jetë reale.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nga takimi me studentët u bë e qartë se atyre u jepet mundësia të kërkojnë të drejtën e tyre në lidhje me vlerësimin e kontrollit të dijeve mbi baza barazie, ndershmërie dhe që respekton të drejtën e ruajtjes së të dhënave personale. Atyre u jepet mundësia e ankimimit, e rishikimit të provimit dhe rivlerësimit nga komisioni i paanshëm. Kjo procedurë është e shpjeguar në rregulloren e programit të studimit dhe zbatohet me rigorozitet nga stafi akademik. Nga ana tjetër ata mund të shprehin mendimin e tyre në pyetësorët, në rubrikën që ka lidhje me barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.</p> <p>[Ref. Vizita në IAL]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><input checked="" type="checkbox"/></p>

<p><b>Standardi V.6</b>  <b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Në Statutin e UMT njihet e drejta e studentit për informim dhe në rregulloret e brendshme të DIEE dhe programit të studimit “bachelor në Inxhinieri Elektrike” shpjegohen procedurat, që institucioni përmes stukturave specifike që ka ngritur, garanton shërbim mbi bazë barazie dhe konform akteve rregullatore të UMT.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me</p>	<p>Në UMT janë në funksionim struktura që kanë si detyrë kryesore dhënie e informacionit, orientimin dhe shërbimet ndaj studentëve. Përveç sekretarisë mësimore, në UMT veprojnë :</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zyra e informimit dhe këshillimit të karierrës</li> <li>• Zyra e shërbimit ndaj studentëve,</li> <li>• Këshilltarët akademikë</li> </ul> <p>Qëllimi i funksionit të këtyre strukturave është të ndjekin në vazhdimësi (prej hyrjes deri në përfundim të studimeve) ecurinë e studentëve dhe i informojnë ata në lidhje me çështje të zhvillimit të programit të studimit, marrin informacion për shqetësimet dhe problemet e studentëve dhe kthejnë përgjigje brenda afateve të vendosura në rregulloret e institucionit. Nga anketimi i studentëve, rezulton se më shumë se 80% e tyre, janë ndierë të mbështetur nga strukturat e UMT si sekretaria mësimore, këshilltari akademik, shërbimi ndaj studentit, zyra IT etj.</p> <p><i>[Evidenca Nr.46 - Rregullore mbi funksionimin e Zyres se Karrieres]</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karierrës. Zyra/njësia për këshillimin e karierrës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Studentët e regjistruar në UMT, marrin pranë sekretarisë mësimore kontakt zyrtar për komunikimin në vazhdimësi. Ky kontakt (adresë email-i) shërben edhe për aksesin e studentëve në platformën “edu4school” kun ë mënyrë periodike merren informacione për zhvillimin e programit studimor. Në shërbim të studentëve është Zyra e Karrierës dhe Alumni, e cila angazhohet në mënyrë periodike për dhënien e informacionit të nevojshëm në rrugëtimin e studentëve prej fillimit e deri në përfundim të programit të studimit. Informacioni që kjo njësi jep, ka rëndësi në lidhje me orientimin e tyre në procesin mësimor, praktikën profesionale, diplomimin si dhe në mbështetjen e institucionit për integrimin e shpejtë dhe efektiv në tregun e punës.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karierrës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Nga takimi me specialistët e kësaj zyre u evidentua përpjekja e vazhdueshme që bëhet prej UMT në ndjekjen e karierrës së studentëve të diplomuar, dhe në UMT ky proces është përgjegjësi e Zyrës së Karrierës dhe Alumni. Nga diskutimi me këtë njësi, u evidentua se mbahen statistika për ecurinë profesionale të studentëve të diplomuar , por nga materialet e depozituara në dosjen e akreditimit (foto me aktivitetet “alumni” në UMT) del nevoja e intensifikimit të përpjekjeve për krijimin e një database me të dhënat e ecurisë profesionale të të diplomuarve, që do të ishte promovimi më efektiv i programit të studimit.</p> <p><i>[Evidenca 52 Rjeti alumni ne UMT]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			☒	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				☒

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UMT mbështetur në Statutin e tij dhe në funksion të arritjes së misionit, zbaton politika në përputhje me ligjin 80/2015 me qëllim rritjen e cilësisë së produktit të programeve të studimit që zhvillon.</p> <p>Për garantimin dhe sigurinë e cilësisë, UMT ka ngritur një strukturë të posaçme, NJSBC që operon sipas akteve rregullatore të brendshme dhe në përputhje me kornizën ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 85 - Manuali i Sigurimit të Cilësisë të Universitetit Metropolitan Tirane]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sipas dokumentacionit në dosjen e akreditimit dhe takimeve në institucion, UMT ka ngritur dhe ka funksionale Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila funksionon në nivel institucioni dhe me përbërje nga të gjitha njësitë kryesore. Qëllimi kryesor i kësaj njësie është zbatimi i strategjisë së UMT për rritjen e vazhdueshme të cilësisë, duke vlerësuar periodikisht procesin akademik, financiar dhe administrativ, proces ku përfshihen: stafi akademik, stafi ndihmës akademik, ekspertë të jashtëm dhe studentët. Raportet vjetore, mbi veprimtarinë akademike e financiare të UMT, të kësaj njësie paraqiten e miratohen në Senatin Akademik, e më pas dërgohen në MASR.</p> <p><i>[Evidenca Nr.86 - Politika e Cilësisë të Universitetit Metropolitan]; [Evidenca Rregullore e NjsBC]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UMT i është nënshtruar periodikisht proceseve të vlerësimit të brendshëm e të jashtëm si dhe akreditimeve institucionale e për programet e studimit që ofron. Këto procese kryhen sipas kornizës ligjore në fuqi dhe janë një mjet efektiv për arritjen dhe sigurimin e cilësisë përmes vlerësimesh analitike e krahasuese të ekspertëve të jashtëm të kësaj fushe me qëllim promovimin e rasteve e metodave të mira që rrisin cilësinë e produktit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Nga ana e NJSBC në UMT bëhen përpjekje të mira për të zbatuar politikat e hartuara nga institucioni dhe përkthimit të tyre në procedura periodike për rritjen e cilësisë së programeve të studimit që UMT ofron. Përmes rregulloreve, përmirësimit të vazhdueshëm të formës dhe përmbajtjes së pyetësorëve, si dhe ndërveprimit me studentët, kjo njësi synon krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional dhe ndërgjegjësimin e përfshirjen e gjithë faktorëve dhe aktorëve të brendshëm të institucionit, pasi vetëm kështu garantohet arritja e misionit të UMT.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				☒

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	<p>UMT e bazon monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë tek departamenti, i cili bën propozimet bazuar kryesisht në kërkesat e tregut të punës. Duke qenë se ato (programet e studimit) paraqesin një pjesë të rëndësishme në zinxhirin e formimit të kuadrove të ardhshëm në gjithë fushat, këto ndryshime propozohen në Dekanat, përcillen në Rektorat tek Sektori i kurrikulave dhe cilësisë, dhe më pas NJSBC e paraqet propozimin në Senatit Akademik, që jep edhe vendimin përfundimtar në lidhje me ndryshimet. Nga ana tjetër, vetë DIEE ka qenë iniciatore e përmirësimit të programit të studimit bachelor në “Inxhinieri Elektrike”, ndryshimet e të cilit janë miratuar (pas plotësimit të procedurës) me Vendimin Nr.437 datë 20/07/2018 të MASR dhe ka hyrë në fuqi për vitin akademik 2018-2019 e në vazhdim.</p> <p><i>[Evidenca Nr. 85 Manuali i Sigurimit të Cilësisë të UMT]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>Nga ana e UMT përdoren mekanizma e procese formale që dokumentohen në lidhje me shqyrtimin, ndryshimin, miratimin e programeve të studimit të ciklit të parë, ndër të cilët përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Raportet e NJSBC për pyetësorët e studentëve</li> <li>• Raportet e DIEE dhe Njesisë kryesore FSHKIT</li> <li>• Analiza e punës hartuar prej NJSBC si dhe propozimi që kjo drejtori i bën Senatit Akademik për ndryshimet në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” konform kriterëve e akteve ligjore në fuqi</li> </ul> <p>Organizimi i aktiviteteve ku fokus është studenti dhe tregu i punës, me qëllim përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit me kërkesat e pritshmëritë e tij (tregut të punës).</p> <p><i>[Evidenca Nr. 13 - Rezultatet e vlersimit të cilësisë 2019/2020]</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	<p>UMT përmes Senatit Akademik ka miratuar krijimin e dy instrumentave që vlerësojnë ecurinë e programeve të studimit në nivel institucioni:</p>

	<p>1) Pyetësoin e studentëve për cilësinë e mësimdhënies nga stafi akademik dhe cilësinë e shërbimeve të dhëna prej stafit administrativ.</p> <p>2) Procesi vetvlerësues i stafit akademik si dhe vlerësimi i brendshëm në nivel instituoni që përgatitet nga NJSBC me të dhënat e marra nga departamentet dhe studentët.</p> <p>Metodologjia e përpunimit të të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve të pyetësorëve bazohet kryesisht në të dhënat sasiore.</p>								
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Raporti final me rezultatet e pyetësorëve të studentëve hartohet prej NJSBC, e cila e bën vlerësimin mbi bazë programesh studimi. Ky raport i dërgohet zyrtarisht Njësite Kryesore e Njësite Bazë, të cilat e bëjnë raportin objekt të diskutimit në department, me qëllim përmirësimin e punës në funksion të mendimeve e sugjerimeve të studentëve.								
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	<p>Nga ana e DIEE, pas diskutimit të raporteve me rezultatet e anketimit të studentëve, hartohet një plan masash me qëllim adresimin e mangësive dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ky plan masash raportohet dhe në Rektorat ku pritët miratimi prej Senatit Akademik në lidhje me masat e propozuara.</p> <p><i>[Evidenca Nr.05, Rregullorja e NJSBC]; [Evidenca Nr.53, Analize e NJSBC për pyetësoret e stafit akademik]; [Evidenca Nr.54- Model i formularit të vlerësimit të cilësisë]</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><input checked="" type="checkbox"/></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<input checked="" type="checkbox"/>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<input checked="" type="checkbox"/>						

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	<p>Në parim, vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit bëhet periodikisht prej IAL-ve, por programi i studimit “bachelor në Inxhinieri Elektrike” me profile “Sistemet e Fuqisë”, “Elektronikë”, “Komunikime Dixhitale”, “Kontroll Inxhinierik”, “Makinieri Elektrike” vetëvlerësohet prej NJSBC të UMT për herë të parë. Kjo për shkak se në vitin 2018 UMT u riorganizua ndërsa porgrami i studimit në shqyrtim u liçensua. Nga ana e kësaj njësie dhe Grupit të Vlerësimit të Brendshëm është përdorur :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të dhënat e bazuara në evidencat e organeve drejtuese si: Senati Akademik e Bordi i Administrimit, njësite administrative si:</li> </ul>



	<p>zyra e finances, zyra e burimeve njerëzore, sekretaria mësimore. Drejtoria e Komunikimit dhe Marrëdhëniet me jashtë,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• rezultati i anketimeve periodike të studentëve,</li> <li>• raportet e FSHKIT dhe DIEE në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor,</li> <li>• kërkesën që tregu i punës ka në lidhje me produkte të çertifikuara , në këtë rast, me programe studimi të akredituara</li> </ul> <p>që kanë shërbyer si bazë për vetvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vetvlerësimit, UMT dhe DIEE kanë përdorur instrumentat e unifikuar për të gjitha programet e studimit: pyetësorin e studentëve dhe më pas procedurën në departament për adresimin e problematikave, propozime që miratohen në Senat pas diskutimeve në Rektorat. Për natyrën specifike që mund të ketë programi i studimit “bachelor në Inxhinieri Elektrike” nuk dokumentohet ndonjë instrument specifik për marrjen e indikatorëve për kryerjen e vetvlerësimit.</p> <p><i>[Evidenca Nr.05, Rregullorja e NJSBC]; [Evidenca Nr.53, Analize e NJSBC per pyetesoret e stafit akademik]; [Evidenca Nr.54- Model i formularit te vleresimit te cilësisë]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UMT ka si praktikë vetvlerësimi në lidhje me cilësinë e programit të studimit përdorimin e metodës së drejtpërdrejtë duke marrë mendimin e studentëve për performancën e stafit akademik, vlerësimin e mësimdhënies e didaktikës. Për vlerësim më të plotë të cilësisë së programit të studimit, DIEE duhet të përdorë edhe metoda të tjera me qëllim matjen e treguesve për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerësimin e kurrikulës,</li> <li>• ushtrimi i kontrollit të brendshëm për mënyrën e zhvillimit të leksioneve/seminareve/laboratoreve,</li> </ul> <p>testime të ndryshme lokale ose ndërinstucionale të standardizuara etj.</p> <p><i>[Vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e</p>	<p>UMT dhe NJSBC përdorin edhe metoda të tërthorta në kuadër të vetvlerësimit të cilësisë së programit të studimit “bachelor në Inxhinieri Elektrike”. Konkretisht :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• organizimi i aktiviteteve studentore, përmes takimit të sipërmarrësve, studentëve të diplomuar dhe stafit akademik e studentëve, jep një opinion të besueshëm në lidhje me cilësinë e programit të studimit.</li> </ul> <p>Nga ana e NJSBC, dhe sektorit të këshillimit të karrierës dhe Alumni, është punuar mirë për krijimin e databazës me studentët e diplomuar</p>

kompetencave të përftuara nga ky program.	dhe ecurinë e tyre profesionale. Nga ana tjetër, krijimi i një forme statistikore të standardizuar për marrjen e mendimit të stafit akademik e administrativ, do të ndihmonte në vetvlerësimin e programit të studimit në një mënyrë më të plotë e nga më shumë këndvështrime.  [Evidenca Nr.05, Rregullorja e NJSBC]; [Evidenca Nr.53, Analize e NJSBC per pyetesoret e stafit akademik]; [Evidenca Nr.54- Model i formularit te vleresimit te cilësisë]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				☒

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Nga ana e UMT përmes akteve rregullatore të brendshme përshkruhen procedura në frymën e politikës së institucionit për sigurimin e cilësisë duke përfshirë aktorët e brendshëm si: stafi akademik, stafi administrativ e studentët. Me qëllim krijimin e një kulture për vetvlerësim të brendshëm real e të dobishëm, duhet që këto akte rregullatore të modifikohen me qëllim përfshirjen edhe të aktorëve të jashtëm të interesuar drejtpëdrejt në cilësinë e produktit që jep programi i studimit “bachelor në Inxhinieri Elektrike”, siç mund të jenë përfaqësues nga biznesi dhe titullarët e stafeve teknike të ndërmarrjeve që operojnë në fushën e inxhinierisë elektrike të industrisë apo energjitikës.  [Evidenca Nr.05, Rregullorja e NJSBC]; [Evidenca Nr.53, Analize e NJSBC per pyetesoret e stafit akademik]; [Evidenca Nr.54- Model i formularit te vleresimit te cilësisë]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në aktet rregullatore të brendshme të UMT, në të gjitha nivelet, ka detyra konkrete të përcaktuara në lidhje me të gjitha palët që janë aktorë dhe faktorë në procesin e vlerësimit dhe përmirësimin të cilësisë së programit të studimit. Në këto rregullore përshkrimi i detyrave specifike për secilin pozicion pune, garanton edhe ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Duke vlerësuar procedurën që ndiqet prej NJSBC dhe DIEE për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, vihet re se në vetvlerësimin e cilësisë së tij përfshihen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• njësia bazë e njësia kryesore me raportin për planin e masave e propozimet për adresimin e problemeve të dala nga anketimi i studentëve.</li> <li>• anëtarët e stafit akademik e administrativ si subjekt i vlerësimit</li> </ul>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. « Q. Stafa », Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• studentët, si pjesë e palës që jep vlerësimet</li> </ul> <p>Kjo gjithpërfshirje garantohet prej procedurës së vlerësimit të sanksionuar në rregulloret e ndryshme në nivel fakulteti dhe departamenti.</p> <p><i>[Evidenca Nr.05, Rregullorja e NJSBC]; [Evidenca Nr.53, Analize e NJSBC per pyetesoret e stafit akademik]; [Evidenca Nr.54- Model i formularit te vleresimit te cilësisë]</i></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm përfshin të gjithë aktorët e brendshëm dhe në këtë proces që kryhet periodikisht nga UMT, respektohet liria akademike dhe integriteti i çdo individi duke shmangur çdo lloj diskriminimi.</p> <p>Ky parim barazie i shprehur si frymë e politikës së ndjekur nga institucioni në gjithë procesin, konfirmohet edhe nga stafi e studentët në takimet me ta .</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Për vlerësim real dhe efektiv të programit të studimit, është i nevojshëm edhe mendimi i aktorëve dhe ekspertëve të jashtëm. Në praktikën e UMT, kjo konsiston në takime me biznesin lokal në workshop-et e organizuara.</p> <p>Do të ishte më e dobishme që veç aktivitetëve të këtij lloji të merreshin mendime edhe nga ekspertë të jashtëm në fushën akademike.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">☒</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			☒	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		☒							

<b>Standardi VI.5</b> <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bazuar në të drejtën për informim, UMT bën të ditur politikën, strategjinë, dhe veprimtaritë që institucioni organizon në kuadër të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Këto informacione seicili student apo stafi i UMT mund t'i aksesojë në faqen zyrtare web të UMT, ku gjen legjislacionin bazë si Statutin, Kodin e Etikës, Rregulloret e UMT, fakulteteve, Departamenteve, programeve të studimit, raporte, vendime të Bordit të Administrimit etj. Gjithashtu gjenden edhe njoftimet për aktivitetet akademike e sportive. Guida e studentit që UMT ka hartuar dhe i jepet çdo studenti në fillim të studimeve, orienton më së miri veprimtarinë e studentëve në planin personal dhe përmirësim të rezultateve akademike të tyre.</p> <p><i>[Faqja web e UMT: <a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a>]</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>NJSBC e UMT publikon raportet e vlerësimit të programit të studimit duke i shpërndarë ato në Njësitë kryesore e Njësitë bazë përkatëse. Këto raporte hartohen duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, ruajtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin. Diskutimi i rezultateve në departamente nuk ka qëllim dënimin e pjesës së stafit që shfaqin problematika por marrjen e treguesve për aspektet e punës akademike që kanë nevojë për rishikim. Ky është një proces që monitorohet në vazhdimësi, përmes orientimeve e sugjerimeve që i jepet stafit akademik dhe marrjes së mendimeve prej studentëve. Edhe pyetësori rishikohet e riformulohet here pas here në përshtatje me situatat e reja të krijuara apo problematikave të evidentuara.</p> <p><i>[Evidenca Nr.05, Rregullorja e NJSBC]; [Evidenca Nr.53, Analize e NJSBC per pyetesoret e stafit akademik]; [Evidenca Nr.54- Model i formularit te vleresimit te cilësisë]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Pas diskutimit të rezultateve të pyetësorëve të studentëve në departament, ky i fundit harton një raport me propozime për planin e masave që adreson problematikën që ka evidentuar pyetësori dhe e dërgon në rektorat dhe për miratim në Senatin Akademik. Qëllimi kryesor në këtë proces është njohja e stafit akademik me pritshmëritë që studentët kanë në lidhje me punën e tyre, plotësimi i mangësive të evidentuara në drejtim të mësimdhënies apo infrastrukturës dhe minimizimi i dobësive të evidentuara për vitet në vazhdim.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Gjithë procesi i vlerësimit të cilësisë për efektivitetin e programit të studimit ka një impakt të konsiderueshëm, pasi :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• rezultatet e raportit të vlerësimit të brendshëm dhe plani i masave i propozuar dhe miratuar, pasqyrohet në planet e punës së departamenteve.</li> <li>• Procesi është periodik, dhe bëhet 2 herë brenda 1 viti akademik. Në anketimin për vitin akademik 2020-2021 morën pjesë 54.3% e studentëve të FSHKIT dhe NJSBC ka hartuar një raport të detajuar me tabela e grafikë për vizualizimin e rezultateve në nivel fakulteti dhe nivel institucioni. Ky raport jep informacion edhe për përmbajtjen dhe strukturën e pyetësorit.</li> </ul> <p>Në këtë proces nxitet pjesëmarrja e gjithë studentëve (por është individual dhe jo i detyrueshëm) dhe iu garantohet atyre anonimiteti i pjesëmarrjes në anketim. Anketimi aksesohet lehtë prej studentëve përmes platformës “edu4school” dhe rezultatet analizohen nga NJSBC.</p> <p><i>[Evidenca Nr.05, Rregullorja e NJSBC]; [Evidenca Nr.53, Analize e NJSBC per pyetesoret e stafit akademik]; [Evidenca Nr.54- Model i formularit te vleresimit te cilësisë]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga ana e UMT organizohen takime të stafit akademik e studentëve, ku NJSBC dhe Drejtoria e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me jashtë informojnë dhe ndërgjegjësojnë ata në lidhje me rolin që kanë në rritjen e cilësisë së programit të studimit në terma afatgjatë.</p> <p><i>[Vizita në institucion]</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<input checked="" type="checkbox"/>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<input checked="" type="checkbox"/>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor "Inxhinieri Elektrike", me profile "Sistemet e Fuqisë", "Elektronikë", "Komunikime Dixhitale", "Kontroll Inxhinierik", "Makineri Elektrike" të Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Metropolitan Tiranë".**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Në Republikën e Shqipërisë ka pak universitete me program studimi të ngjashëm me "Bachelor në Inxhinieri Elektrike", si rrjedhim UMT mund të përfitojë në tërheqjen e studentëve relativisht më të mirë me interes në këtë fushë.
2. UMT ka ndërtuar struktura institucionale me përkushtim të lartë në drejtim të promovimit të programeve të studimit. Gjithashtu ka ngritur infrastrukturë bashkëkohore (auditore, klasa, laboratore) që krijojnë kushte komode në ndjekjen e programit të studimit
3. UMT ka realizuar marrëveshje me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit duke krijuar mundësi të mira mobiliteti për stafin akademik dhe studentët.
4. Programi i studimit "bachelor në Inxhinieri Elektrike" ka vazhdimësi në ciklin e dytë të studimeve.

**Pika të dobta:**

1. Numri i pamjaftueshëm i titujve me karakter profesional i literaturës në bibliotekën e institucionit UMT.
2. Cilësia relativisht e ulët e studentëve në hyrje të programit të studimit.
3. Numri i madh i profileve brenda programit të studimit "Bachelor në Inxhinieri Elektrike" në UMT krijon vështirësi për gjetjen (konvergjencën e ekspertizës) e stafit akademik të specializuar sipas fushave të studimit të këtyre profileve.
4. Stafit akademik efektiv duhet të jetë më aktiv në drejtim të kërkimit shkencor.
5. Moshë mesatare e stafit akademik PAE me tituj akademikë e grada shkencore është e lartë. Kategoria "Profesor" ka vite që ka mbushur moshën e pensionit.

6. Ky program studimi ka 5 drejtime: "Sistemet e Fuqisë", "Elektronikë", "Komunikime Dixhitale", "Kontroll Inxhinierik", "Makineri Elektrike", nga të cilët janë aktiv vetëm dy prej tyre

#### **Rekomandime:**

1. UMT duhet të rrisë përpjekjet për rekrutim stafi akademik PAE me grada shkencore e tituj akademikë në moshë relativisht të re, për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm të programit të studimit "Bachelor në Inxhinieri Elektrike"
2. UMT duhet të shikojë mundësinë e investimeve në lidhje me ngritjen e laboratorëve për lëndë të formimit profesional si: Transmisione elektrike, makina elektrike, PLC etj.
3. UMT duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për rritjen e numrit të titujve në bibliotekën e institucionit. Ky pasurim i literaturës duhet të bëhet me botime të 5 viteve të fundit dhe sipas fushave prioritare të studimit të DIEE.
4. UMT duhet të gjejë mundësitë për kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik efektiv si një domosdoshmëri për rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Laboratorët bashkëkohorë dhe marrëdhëniet me subjekte lokale që menaxhojnë objekte me teknologji të avancuar, do të krijojnë mundësi më të mira për zhvillimin e kërkimit shkencor.
5. UMT duhet të tentojë rritjen e cilësisë së studentëve në hyrje të programit të studimit "bachelor në Inxhinieri Elektrike".

### **Conclusions of the study program evaluation of the first cycle Bachelor "Electrical Engineering", with the profile "Power Systems", "Electronics", "Digital Communications", "Engineering Control", "Electrical Machinery" of the Higher Education Institution "Tirana Metropolitan University".**

#### **Strengths and affirmations:**

1. In the Republic of Albania there are few universities with a study program similar to "Bachelor in Electrical Engineering" as a result UMT can benefit in attracting relatively better students with interest in the field.
2. UMT has built institutional structures with high commitment in terms of promoting study programs. It has also set up modern infrastructure (auditoriums, classrooms, laboratories) that create comfortable conditions for attending the study program.
3. UMT has realized agreements with counterpart institutions inside and outside the country, creating good mobility opportunities for academic staff and students. The study program "bachelor in Electrical Engineering" has continuity in the second cycle of studies.
- 4.

**Weaknesses:**

1. Insufficient number of titles of professional literature in the library of the UMT institution.
2. Low classification of students at the entrance of the study program.
3. The large number of profiles within the study program "Bachelor in Electrical Engineering" at UMT creates opportunities for finding (convergence of expertise) and academic staff of science according to the fields of study for these profiles.
4. Effective academic staff should be more active in terms of research.
5. The average age of PAE academic staff with academic titles and scientific degrees is high. The "Professor" category has been retired for years.
6. This study program has 5 directions: "Power Systems", "Electronics", "Digital Communications", "Engineering Control", "Electrical Machinery", of which only two are active.

**Recommendations:**

1. UMT should increase the efforts for recruitment of PAE academic staff with scientific degrees and academic titles at a relatively young age, to guarantee the sustainable development of the study program "Bachelor in Electrical Engineering"
2. UMT should look at the possibility of investments related to the establishment of laboratories for vocational training subjects such as: Electric transmissions, electric cars, PLC, etc.
3. UMT should make continuous efforts to increase the number of titles in the library of the institution. This enrichment of the literature should be done with publications of the last 5 years and according to the priority fields of study of DIEE.
4. UMT should find opportunities for further qualification of effective academic staff as a necessity for increasing the quality of teaching. Contemporary laboratories and relationships with local entities that manage facilities with advanced technology, will create better opportunities for the development of scientific research.
5. UMT should try to increase the quality of students at the entrance of the study program "bachelor in Electrical Engineering".



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				<input checked="" type="checkbox"/>
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			<input checked="" type="checkbox"/>	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				<input checked="" type="checkbox"/>
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			<input checked="" type="checkbox"/>	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				<input checked="" type="checkbox"/>
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				<input checked="" type="checkbox"/>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>			<input checked="" type="checkbox"/>	